

Majlind Ferdulli

GJEOGRAFIA

Për klasën e nëntë të arsimit të mesëm të ulët



Libri i mësimdhënësit/es

duk gjini
shtëpia botuese publishing house

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJA

QËLLIMI.....	5
PLANI VJETOR	6
Plani i vlerësimit për lëndën e Gjeografisë - Klasa e Nëntë (9)	8
PLANI DYMUJOR	15
Shtator - Tetor	15
PLANI DYMUJOR	18
Nëntor - Dhjetor	18
PLANI DYMUJOR	21
Janar - Shkurt - Mars.....	21
PLANI DYMUJOR	24
Prill - Maj - Qershor	24
Njësia mësimore: Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore të Gadishullit Ballkanik	27
Njësia mësimore: GADISHULLI BALLKANIK - VEÇORITË SHOQËRORE-EKONOMIKE	30
Njësia mësimore: KOSOVA – pozita gjeografike	32
Njësia mësimore: NDËRTIMI GJEOLGJIK DHE RELIEVI I TERRITORIT TË KOSOVËS	35
Njësia mësimore: Klima	37
Njësia mësimore: Hidrografia	39
Njësia mësimore: Bota bimore dhe shtazore	42
Njësia mësimore: Popullsia dhe veçoritë e saj - Popullimi i hapësirës së Kosovës	45
Njësia mësimore: Lëvizja natyrore e popullsisë dhe migrimet e popullsisë së Kosovës	47
Njësia mësimore: Vendbanimet	49
Njësia mësimore: Veçoritë ekonomike të Kosovës dhe faktorët e zhvillimit ekonomik	53
Njësia mësimore: Faktorët shoqërorë në zhvillimin e bujqësisë.....	56
Njësia mësimore: Industria dhe energjetika	58
Njësia mësimore: Komunikacioni, tregtia, zejtaria dhe turizmi	61
Testimi i parë	63
Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve - Klasa IX.....	64

Njësia mësimore: Regjionet gjeografike: Regjioni Lindor i Kosovës.....	66
Njësia mësimore: Regjionet gjeografike: Regjioni Perëndimor i Kosovës.....	69
Njësia mësimore: Ushtrime: Regjionet gjeografike të Kosovës	71
Njësia mësimore: Republika e Kosovës, veçoritë juridike, politike, administrative dhe gjeografike dhe sfidat drejt BE-së.....	73
Njësia mësimore: Shqipëria - pozita gjeografike	75
Njësia mësimore: Veçoritë natyrore të Republikës së Shqipërisë	78
Njësia mësimore: Popullsia e Shqipërisë.....	81
Njësia mësimore: Zhvillimi ekonomik i Republikës së Shqipërisë	83
Njësia mësimore: Vlerësim i njohurive: Ekonomia e Shqipërisë	85
Testimi i dytë	87
Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve - Klasa IX.....	89
Njësia mësimore: Transporti, tregtia e jashtme dhe turizmi	89
Njësia mësimore: Prezantim i punimeve: Republika e Shqipërisë	91
Njësia mësimore: Regjionet gjeografike - Regjioni i Ultësirës Perëndimore.....	93
Njësia mësimore: Krahu Malorë Qendrorë e Shqipërisë.....	95
Njësia mësimore: Krahu Malorë Veriorë dhe Jugorë e Shqipërisë.....	97
Njësia mësimore: Maqedonia Veriore.....	101
Njësia mësimore: Republika e Malit të Zi.....	104
Njësia mësimore: Serbia.....	107
Testimi i tretë	109
Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve - Klasa IX.....	110

QËLLIMI

Qëllimi i këtij libri është të udhëzojë dhe ndihmojë mesimdhënësit që japin mesim në klasën e nëntë, për të përmbushur synimet e kurrikulës në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, lënda - gjeografi, për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe kompetencave kyçe të nxënësit.

Libri i mësuesit sjell shembuj konkretë të planit vjetor, dymujor dhe planeve ditore nëpërmjet përdorimit të metodologjive të përshtatshme të mesimdhënies/nxënies për lëndën e gjeografisë.

Prandaj ky libër përpiqet që të mbështesë mesimdhënësit e gjeografisë në disa nga bazat e planifikimit, por nuk mund të zëvendësojë përvojën tuaj të veçantë si mesimdhënës. Për më tepër libri jep shembuj për planifikim, që mund të kontribuojë në zhvillimin më efikas të orës mesimore, gjithnjë duke u mbështetur në strategji bashkëkohore për zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

Radhitja e njësive mesimore në tekst është bërë duke ndjekur formën klasike të shtjellimit të materies gjeografike. Pa marrë parasysh radhitjen e njësive mesimore, apo harmonizimin dhe kohën me lëndët tjera mesimore, përmbajtja e planifikimit siguron shtjellimin e plotë të njësive (pjesën natyrore dhe shoqërore-ekonomike) si dhe përfshin të gjitha rezultatet e lëndës dhe fushës kurrikulare që mund të arrihen nëpërmjet lëndës së gjeografisë.

Jemi të vetëdijshëm se teksti mund të ketë lëshime, andaj mirëpresim vërejtje, këshilla, sugjerime që me shumë dashamirësi do të merren parasysh gjatë ribotimit eventual të tij.

autorë

PLANI VJETOR

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi Klasa: IX (nëntë)

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE					
PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)	
Shtator - Tetor	Nëntor - Dhjetor	Janar - Shkurt - Mars		Prill - Maj - Qershor	
1. Gadishulli Ballkanik	2. Gjeografia e Kosovës	2. Gjeografia e Kosovës	3. Gjeografia e Shqipërisë	3. Gjeografia e Shqipërisë	4. Maqedonia Veriore Mali i Zi Serbia
2. Gjeografia e Kosovës		3. Gjeografia e Shqipërisë		4. Maqedonia Veriore Mali i Zi Serbia	5. Sfidat e Kosovës dhe rajonit përballë kërkesave për zhvillim të qëndrueshëm
No - 1-9 (9)	No - 10-18 (9)	No - 19-25 (7)	No - 26-29 (4)	No - 30-36 (7)	No - 37-38 (2)

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave brenda vitit	
I. Komunikues efektiv	I - 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8;
II. Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik	II - 1, 2, 4, 5, 7, 8;
III. Kompetenca të mësuarit për të nxënë – Nxënës i suksesshëm	III - 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8;
IV. Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis – Kontribues produktiv	IV - 1, 4, 6;
VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	VI - 1, 7, 9

Tabela për orët mësimore sipas temave dhe nëntemave të ndara sipas tipit të orës

Temat mësimore	Nr.përgji.	Zhvillim	Testim i njohurive	Veprimtari praktike	Punimet	Vlerësim
1. Gadishulli Ballkanik	2	2				
2. Kosova	19					
➤ Veçoritë e përgjithshme natyrore të Kosovës	5	5				
➤ Veçoritë e popullsisë së Kosovës	4	3	1			
➤ Veçoritë ekonomike të Kosovës	6	4			1	1
➤ Regjionet gjeografike të Kosovës	4	3	1			
3. Shqipëria	13					
➤ Veçoritë e përgjithshme natyrore të Shqipërisë	3	2	1			
➤ Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë	6	3		1	1	1
➤ Regjionet gjeografike të Shqipërisë	4	3		1		
4. Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Mali i Zi	4					
➤ Veçoritë e përgjithshme natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.	4	3			1	
➤ Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.						
	38 orë	28	3	2	2	3

Plani i vlerësimit për lëndën e Gjeografisë - Klasa e Nëntë (9)

Rezultatet e të nxënit për shkallën 4 dhe kompetencat kryesore që janë përzgjedhur të arrihen nga lënda e gjeografisë

I Kompetenca komunikim dhe të shprehurit - Komunikues efektiv

1. Transmeton saktë të dhënat e mbledhura për një temë konkrete, në formë tekstuale, numerike, verbale, elektronike apo në ndonjë formë tjetër të të shprehurit.
2. Përshkruan një ngjarje, të dhënë si detyrë, të lexuar ose të dëgjuar më parë, në formë verbale, vizuale ose me shkrim, duke ruajtur rrjedhën logjike të saj.
3. Diskuton për një temë të caktuar në gjuhën amtare, në gjuhën angleze ose në gjuhën e dytë të huaj në lëndë të ndryshme, duke respektuar rregullat e pjesëmarrjes efektive për këmbimin e informatave dhe të ideve.
4. Harton një tekst, deri në pesëqind fjalë, duke e vazhduar një rrëfim gojor apo tekst të lexuar paraprakisht duke u bazuar në imagjinatën e vet.
5. Prezanton para të tjerëve një projekt për një temë të dhënë, të përgatitur vetë ose në bashkëpunim me grupin, duke gërshetuar format e komunikimit verbal, elektronik dhe veprimin praktik.
6. Analizon përmbajtjen dhe kuptimin e nocioneve (koncepteve) të reja, duke përdorur leksikon adekuat, të përshtatshëm dhe të saktë dhe i bën ato pjesë të dosjes mësimore.
7. Identifikon burime të ndryshme të informacionit për arsimim, orientimin profesional dhe harton një plan individual për zhvillimin e karrierës në fushën e komunikimit (gazetar etj.).
8. Inicion biseda shoqërore me moshatarët dhe me të rriturit për tema me interes mësimor/shoqëror, duke shtruar pyetje për temën dhe duke u përgjigjur dhe veçuar informatën kryesore.

II. Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik

1. Paraqet, në formë gojore ose të shkruar, grafike, me simbole, argumente të veçanta për të sforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për një problem nga fusha të caktuara.
2. Përzgjedh informata nga burime të ndryshme, për një temë konkrete, i klasifikon ato në bazë të një kriteri të caktuar dhe i përdor ato për marrjen e një vendimi apo për zgjidhjen e një problemi/detyre.
4. Përpunon idenë e vet në një projekt me shkrim për një çështje të caktuar duke propozuar aktivitetet kryesore, përcakton qëllimin kryesor, afatet, vendin, personat, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e atyre aktiviteteve si dhe parasheh pengesat e mundshme gjatë realizimit të tyre.

- | |
|---|
| 5. Arsyeton ndërmarrjen e hapave konkretë, të cilët kanë rezultuar në përfundimin e një detyre/aktiviteti, zgjidhjen e një problemi ose të ndonjë punimi në klasë/shkollë apo gjetiu. |
| 7. Interpreton me fjalë, me shkrim/me gojë një rregull, koncept apo proces të caktuar, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë nga situata të jetës së përditshme. |
| 8. Identifikon me anë të krahasimit dallimet dhe ngjashmëritë midis ligjeve dhe dukurive që ndodhin në natyrë me ato në shoqëri, duke vënë në dukje lidhjen shkak-pasojë midis këtyre dukurive. |

III Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm

- | |
|---|
| 1. Regjistron në formë të shkruar, grafike, me TI etj., informatat ose faktet për një temë të caktuar duke i veçuar, me anë të teknikave të ndryshme, pjesët e rëndësishme dhe më pak të rëndësishme, të nevojshme për atë temë/detyrë të dhënë. |
| 2. Shfrytëzon në mënyrë efikase fjalorët, enciklopeditë dhe teknologjinë informative apo burimet e tjera gjatë ndërtimit të një ideje ose projekti me bazë klase/shkolle ose jashtë saj. |
| 3. Regjistron në skeda dhe teknika të tjera të veçanta, TI etj., informatat ose faktet a formulat për një temë të caktuar duke i radhitur ato sipas llojit, burimit dhe rëndësisë mësimore të tyre. |
| 4. I parashtron pyetje vetes për çështjet që trajton dhe organizon mendimet për të gjetur përgjigje për temën apo problemin e caktuar duke regjistruar përparimin apo ngecjen derisa të gjejë zgjidhjen përfundimtare. |
| 5. Paraqet/skicon idetë e veta për ecurinë dhe mënyrën e zhvillimit të një aktiviteti duke e sqaruar dhe duke argumentuar më pas këtë para të tjerëve. |
| 6. Ndjek në mënyrë të pavarur udhëzimet apo skicat e dhëna në libër, skicë, plan, partiturë muzikore, skenar, koreografi etj., ose të ndonjë burimi tjetër, për të përformuar një veprim, aktivitet ose detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| 7. Shfrytëzon në mënyrë të efektshme teknika të ndryshme gjatë të nxënës të temës së dhënë duke veçuar informatat që i kupton nga informatat e reja, të panjohura, si dhe informatat që për të mbeten ende të paqarta. |
| 8. Zbaton elementet e dosjes personale për identifikimin e anëve të veta të forta, i shfrytëzon ato për orientim në profesionin e ardhshëm si dhe për vetëvlerësimin e përparimit, qoftë përmirësimin, qoftë ngecjen në fusha të ndryshme mësimore. |

IV Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis - Kontribues produktiv

- | |
|---|
| 1. Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe në grupe për zhvillimin e komunitetit duke paraqitur, në forma të ndryshme të të shprehurit, shembuj konkretë nga jeta e përditshme. |
| 4. Përdor programet kompjuterike për përpunimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizatimeve/diagrameve të nevojshme për përgatitjen e materialeve individuale apo/dhe publikimeve të ndryshme të shkollës. |

6. Përdor materiale, burime të ndryshme informimi dhe teknologjinë në shkollë dhe në jetën e përditshme si ndihmë për përparim në mësim dhe për orientim në karrierë.

VI Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm

1. Praktikton të drejtat dhe detyrimet e qytetarisë në situata konkrete jetësore të përditshme, qoftë në klasë, qoftë në shkollë apo gjetiu (si: gjatë diskutimit, respektimit të mendimit të tjetrit etj.).

7. Përgatit një aktivitet me bashkëpjesëmarrje me të tjerët, duke përdorur tolerancën si mjet për promovimin e diversitetit kulturor, etnik, gjinor, fetar, social etj., në shkollë apo në komunitet.

9. Prezanton pa ngurrim të kaluarën e familjes, të rrethit shoqëror ose të personaliteteve dhe ngjarjeve kryesore të kombit të vet, për të krahasuar të tashmen me të kaluarën dhe për të nxjerrë përfundime për të ardhmen.

Plani i vlerësimit për lëndën e gjeografisë

Plani është i përgatitur në bazë të ligjit të Arsimit Parauniversitar dhe në harmoni me Udhëzimin Administrativ për vlerësimin e nxënësve sipas Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Mësimdhënësi harton sipas specifikave të veta planin e vlerësimit për lëndën e gjeografisë për një vit shkollor. Plani hartohet në mbështetje të dy komponentëve:

Vlerësimit përmblendhës 1 (VP1) 60%, që përfshin këto instrumente vlerësuese:

- Detyrat e shtëpisë (15%);
- Prezantime me gojë (30%);
- Teste (teste për periudha të shkurtra kohore) (15%);
- Projekt (20%);
- Angazhimi në klasë (20%);

Vlerësimit përmblendhës 2 (VP2):

- *Test/instrument përfundimtar, përmblendhës 40%*

Nxënësi gjatë vitit shkollor vlerësohet me vlerësim përmblendhës së paku dy herë (VP1 dhe VP2) për çdo dy/tremujorësh. Nga këto dy nota përmblendhëse, fitohet nota përmblendhëse përfundimtare sipas formulës: $60\% \times VP1 + 40\% \times VP2 = 0.6 \times VP1 + 0.4 \times VP2 =$ nota e një periudhe kohore (nota përmblendhëse), dhe kjo vendoset në librin e klasës.

VP1 është vlerësim përmblendhës, ku arsimtari i lëndës i përzgjedh sipas nevojës së lëndës fushat për vlerësim në tabelën e dhënë, pra nga të gjitha fushat në VP1 përzgjedh disa nga instrumentet më të nevojshme. VP2 është vlerësim përmblendhës, ku arsimtari përzgjedh vetëm njërin nga instrumentet për vlerësim në fushat e VP2-it.

Shembull - një model vlerësimi nga Gjeografia.

Tek fusha e VP1-it marrin vetëm ato instrumente të vlerësimit dhe u japim përqindje sipas dëshirës së mësimdhënësit të lëndës:

- Detyrat e shtëpisë 15%
- Pyetje-përgjigje 30%
- Test kontrollues 15%
- Projekt 20%
- Aktivitet në klasë 20%

Për të nxjerrë notën e parë, pra VP1, veprojmë kështu:

$3 \times 0.15 + 5 \times 0.15 + 4 \times 0.30 + 5 \times 0.20 + 3 \times 0.20 = 0.45 + 0.75 + 1.20 + 1.0 + 0.60 = 4$, pra nota e parë në ditat VP1 është 4

Sqarim: nota e parë VP1 ka instrumente të vlerësimit të vazhdueshëm, pra nota nuk duhet të bartet në ditat menjëherë pas 1 muaji apo edhe pas 2 muajve, po duhet të përfshijë vlerësimin gati të gjithë periudhës.

Testi përmbljedhës (40%) 100% nga vlera e notuar.

Sqarim: pra nota e cila del nga ky vlerësim përshkruhet menjëherë në ditat dhe vendoset si notë e dytë, pra VP2.

Notën e VP1 $\times 0.60 + VP2 \times 0.40 = 4 \times 0.60 + 5 \times 0.40 = 2.4 + 2.0 = 4.4 \sim 4$ pra mbyllet në periudhë nota 4.

Nota përfundimtare e një lënde mësimore formohet nga mesatarja aritmetike e notave të mbyllura në të tria periudhat mësimore.

Teknikat për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive:

• Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.) • Vlerësimi me shkrim • Vlerësimi me anë të dëgjimit • Vlerësimi përmes punës praktike • Vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve • Vlerësimi i projekteve kurrikulare, lëndore ose ndërlëndore • Esetë • Portofoli

Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qëllimi të caktuar.

Periudhat dhe koha

Periudhat			
	Periudha e parë	Periudha e dytë	Periudha e tretë
15%	<i>Pas çdo njësie të plotë</i>	<i>Pas çdo njësie të plotë</i>	<i>Pas çdo njësie të plotë</i>
30%	<i>I vazhdueshëm</i>	<i>I vazhdueshëm</i>	<i>I vazhdueshëm</i>
15%	<i>Pas përfundimit të kapitujve/temave</i>	<i>Pas përfundimit të kapitujve/temave</i>	<i>Pas përfundimit të kapitujve/temave</i>
20%	<i>I vazhdueshëm Puna me harta dhe përdorimi i TiK...</i>	<i>I vazhdueshëm Puna me harta dhe përdorimi i TiK...</i>	<i>I vazhdueshëm Puna me harta dhe përdorimi i TiK...</i>
20%	<i>Në fund të temës</i>	<i>Në fund të temës</i>	<i>Në fund të temës</i>
40%	<i>Deri në 10 ditë para përfundimit të periudhës</i>	<i>Deri në 10 ditë para përfundimit të periudhës</i>	<i>Deri në 10 ditë para përfundimit të periudhës</i>

Kriteret që duhen plotësuar për instrumentet vlerësuese në VP1:

Instrumenti 1 - Angazhimi në klasë (20%)

Nota 5. Nxënësi është aktiv në bashkëbisedim me mësimitdhënësin duke parashtruar pyetje për njësinë mësimore dhe duke ofruar përgjigje të mendimit kritik. Nxënësi demonstroi punë grupore duke pranuar shpesh rolin e liderit brenda grupit, të përcaktuar nga mësimitdhënësi apo anëtarët e grupit.

Nota 4. Nxënësi heziton në pjesëmarrje të bashkëbisedimit me mësimitdhënësin, por bashkëpunon brenda grupit duke demonstruar angazhim në zgjidhjen e detyrës.

Nota 3. Nxënësi nuk bashkëbisedon lirshëm me mësimitdhënësin, ndërsa gjatë punës në grup dhe gjatë punës individuale demonstroi të kuptuarit e detyrës dhe duke marrë rolin e prezantimit të rezultateve individuale apo rezultateve të dala nga grupi.

Nota 2. Nxënësi është pjesëmarrës i punës në grup, duke treguar nivel të njohjes së problematikës. Nxënësi nuk refuzon ndonjë detyrë të dhënë nga anëtarët e grupit, detyrë e cila ka ndikim në rezultatin përfundimtar të grupit.

Nota 1. Nxënësi është pjesëmarrës pasiv brenda grupit. Nxënësi nuk refuzon bashkëbisedim me mësimitdhënësin, por gjithnjë ka vështirësi në komunikim verbal. Nxënësi pjesërisht përgatitet me material pune. Nxënësi nuk fiton asnjë pikë (0 pikë). Në rastet kur nxënësi nuk respekton punën e grupit, nuk pranon bashkëbisedimin me mësimitdhënësin, nuk tregon përgatitje minimale me material mësimor.

Instrumenti 2 - Detyrat e shtëpisë (15%). Nxënësi sjell detyrat e shtëpisë me paralajmërim të mësimitdhënësit.

Nota 5. Nxënësi i cili nuk i sjell detyrat e shtëpisë më së shumti deri në dy herë, por kurdo që i sjell, detyrat e shtëpisë duhet të jenë të kompletuara edhe për kohën kur nuk i ka sjellë (kjo për shkakun sepse ka, mundësi t'i harrojë apo ndonjë arsye tjetër). Nxënësi i cili nuk ka më shumë se tri përgjigje të pasakta, nga të gjitha detyrat e kontrolluara. Nxënësi tregon etikë të mirëmbajtjes së fletores së detyrave.

Nota 4. Nxënësi i cili nuk i sjell 3-5 herë detyrat e shtëpisë, por kurdo që i sjell, detyrat e shtëpisë duhet të jenë të kompletuara edhe për kohën kur nuk i ka sjellë (kjo për shkakun sepse ka mundësi t'i harrojë apo ndonjë arsye tjetër). Nxënësi i cili nuk ka më shumë se 6 përgjigje të pasakta, nga të gjitha detyrat e kontrolluara. Nxënësi tregon etikë të mirëmbajtjes së fletores së detyrave.

Nota 3. Nxënësi i cili nuk i sjell 6 e më shumë herë detyrat e shtëpisë, por kurdo që i sjell, detyrat e shtëpisë nuk janë të kompletuara (mungojnë së paku detyrat e një njësie mësimore). Nxënësi i cili ka 7 e më shumë përgjigje të pasakta, nga të gjitha detyrat e kontrolluara. Nxënësi tregon etikë të mirëmbajtjes së fletores së detyrave.

Nota 2. Nxënësi i cili nuk i sjell 6 e më shumë herë detyrat e shtëpisë, por kurdo që i sjell, detyrat e shtëpisë nuk janë të kompletuara (mungojnë detyrat e dy e më shumë njësive mësimore). Nxënësi i cili ka 7 e më shumë përgjigje të pasakta, nga të gjitha detyrat e kontrolluara. Nxënësi nuk tregon etikë të mirëmbajtjes së fletores së detyrave.

Nota 1. Nxënësi i cili nuk i sjell shumë herë detyrat e shtëpisë, por kurdo që i sjell, detyrat e shtëpisë nuk janë të kompletuara (së paku posedon detyrat e tri njësive mësimore). Nxënësi i cili ka treguar përpjekje për të dhënë përgjigje të sakta, nga të gjitha detyrat e kontrolluara. Nxënësi nuk tregon etikë të mirëmbajtjes së fletores së detyrave. Nxënësi nuk fiton asnjë pikë (0 pikë). Në rastet kur nxënësi nuk respekton asnjë kriter.

Instrumenti 3 - Prezantim me gojë (30%). Nxënësi vlerësohet sipas standardeve të vlerësimit, të përshkruara në UA, Kurrikulën bërthamë dhe Udhëzuesin për vlerësim.

Nota 5. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin dhe ofron fakte, argumente dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve. Ofron faktet gjeografike, njih objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik.

Nota 4. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin dhe ofron fakte dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve, jo në formë shumë të saktë. Ofron faktet gjeografike, njih objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik, jo shumë të saktë.

Nota 3. Nxënësi i përgjigjet pyetjeve të arsimtarit, por jo mjaftueshëm. Ka shprehje të rrjedhshme dhe deri diku të logjikshme, ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell më me ngecje nga mungesa e leximit të mjaftueshëm. Ofron faktet gjeografike, njih disa objekte gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike (ato që i di) si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; Paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to.

Nota 2. Nxënësi mundohet të bisedojë, ofron fakte gjatë bisedës, por shumë pak. Vërehet mungesa e leximit, nuk i plotëson as 30% të kriterëve të lart- përmendura.

Nota 1. Nxënësi nuk u përgjigjet pyetjeve, nuk bashkëbisedon. Nuk i plotëson kriteret e lartpërmendura as 20%.

PLANI DYMUIJOR

Shtator - Tetor

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda mësimore: Gjeografi

Klasa: IX (nëntë)

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave brenda dymujorit

1.Kompetenca komunikim dhe të shprehur - Komunikues efektiv	I-1, 2, 3, 4, 5, 6,7, 8;
2.Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik	II- 1, 2, 4, 5, 7, 8;
3.Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm	III- 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8;
4.Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv	IV- 1, 4, 6;
5.Kompetenca personale - Individ i shëndoshë	V-
6.Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm	VI- 1,7,9

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave

RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to

1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.
3; 3.1, 3.2 4; 4.1, 4.2

Konceptet:

Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore; Proceset shoqërore dhe natyrore

Teksti: Gjeografia 9; Fletore pune 9, ATLAS GJEOGRAFIK

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit
<p>Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia e Gadishullit Ballkanik dhe shteteve përbërëse të tij.</p> <p>Veçoritë e përgjithshme natyrore të Kosovës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ●Shpjegon pozitën gjeografike të Gadishullit Ballkanik dhe veçoritë e kësaj pozite, përparësitë dhe mangësitë eventuale te kësaj pozite. ●Përshkruan pozitën gjeografike të Kosovës dhe lidhjen e saj rrugore nëpërmjet luginave lumore dhe qafave malore me vendet fqinje. ●Analizon pozitën gjeografike të Shqipërisë, duke veçuar përparësitë e saj (dalja në Detin Adriatik dhe Jon si dhe lidhjet tani më të mira rrugore me Kosovën dhe vendet fqinje). ●Dallon shtetet përbërëse të Gadishullit Ballkanik, i krahason ato mes vete dhe me shtetet përtej tyre, dhe pozitën gjeografike në Gadishull. ●Analizon pozitën gjeografike të shteteve fqinje të Kosovës, me theks vazhdimësinë territoriale e etnike të popullsisë shqiptare: Kosovë - Maqedonia e Veriut, Serbi, Mali i Zi. ●Dallon karakteristikat e përgjithshme esenciale natyrore përbërëse të Gadishullit Ballkanik. ●Argumenton se përmes cilave tërësi morfologjike (luginave, luginave grykore e qafa malore) lidhet Kosova me vendet përreth dhe me cilat shtete ka kufij natyrorë dhe etnikë. 	<p>1. Gadishulli Ballkanik: Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore të Gadishullit Ballkanik</p> <p>2. Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Gadishullit Ballkanik</p> <p>3. Gjografia e Kosovës: Pozita gjeografike</p> <p>4. Ndërtimi gjeologjik dhe relievi i Kosovës</p> <p>5. Klima</p>	<p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p>	<p>Metoda parafolese e mbështetur me demonstrim vizual dhe harta. Punë në grupe të ekspertëve (metoda bashkëpunuese).</p> <p>Metoda e punës me grupe të mëdha. Metoda bashkëpunuese dhe ilustruese, e përcjellë me ekspikim nga teksti në hartë.</p> <p>Parafolese e mbështetur me ekspikim të hartës. Bashkëbiseduese dhe shpjegim grafikësh me krahasim dhe identifikim.</p> <p>Metoda parafolese dhe bashkëbiseduese. Analizë dhe sintezë e materialit, e përcjellë me ekspikim sipas hartës dhe shënimeve.</p> <p>Metoda parafolese dhe bashkëbiseduese. Analizë dhe sintezë e</p>	<p>Vlerësim i punës në grupe dhe individuale. Vlerësim i njohurive të fituara dhe aktiviteteve në klasë sipas listës së kontrollit.</p> <p>Vlerësim i detyrave të realizuara në klasë dhe bashkëpunimi në mes nxënësve.</p> <p>Vlerësim individual dhe në grup. Leximi dhe shpjegimi i punimit sipas kriterëve të paraqitura, përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve.</p> <p>Vlerësim individual dhe në grup (bashkëpunimi). Leximi dhe përdorimi i hartës si dhe artikulimi (ndërlidhja) e shënimeve.</p> <p>Vlerësim i punës individuale. Vlerësim i njohurive të fituara duke i mbështetur ato me argumentim dhe</p>

<p>Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Kosovës</p>	<ul style="list-style-type: none"> ●Shpjegon veçoritë kryesore të ndërtimit gjeologjik ●Dallon llojet kryesore të shkëmbinjve dhe mineraleve të dobishme prezente në truallin e Kosovës ●Dallon tërësitë kryesore relievoe të Kosovës ●Dallon veçoritë klimatike dhe shtrirjen e përafërt të tyre në territorin e Republikës së Kosovës ●Diferencon elementet kryesore klimatike mes rrafshit të Dukagjinit dhe Kosovës. ●Shpjegon karakteristikat themelore hidrografike të Republikës së Kosovës. ●Identifikon pellgjet kryesore lumore në Kosovë ●Dallon tipat gjenetikë të liqeneve dhe shtrirjen e tyre në Kosovë ●Shpjegon llojet kryesore të tokave në Kosovë dhe shtrirjen e përafërt të tyre ●Shpjegon tiparet kryesore floristike dhe faunistike të Kosovës dhe elementet dalluese në mes të rajoneve të ndryshme brenda vendit. ●Dallon regjionet kryesore të Kosovës (regj. Lindor dhe Perëndimor) duke i diferencuar në bazë të veçorive natyrore dhe humane të tyre. ●Analizon shkaqet (faktorët) e popullimit të hershëm të Kosovës. ●Argumenton lashtësinë e popullsisë shqiptare dhe të popujve të tjerë në Kosovë. ●Arsyeton shkaqet e ndryshimit të numrit të popullsisë shqiptare dhe të popujve të tjerë gjatë periudhave historike. ●Analizon dallimet në dendësinë e popullsisë mes regjioneve brenda Kosovës. 	<p>6. Hidrografia</p>		<p>materialit, e përcjellë me eksplikim sipas hartës dhe shënimeve.</p>	<p>artikulim të shënimeve të fituara.</p>
		<p>7. Tokat, bota bimore dhe shtazore</p>	<p>1</p>	<p>Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese si dhe ajo identifikuese dhe eksplikuese me hartë.</p>	<p>Vlerësim i punës individuale. Vlerësim i njohurive të fituara duke i mbështetur ato me shpjegim me hartë (aktiviteti).</p>
		<p>8. Popullsia dhe veçoritë e saj</p> <p>POPULLIMI I TERRITORIT TË KOSOVËS</p>	<p>1</p>	<p>Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese. Analizë dhe sintezë e materialit, e përcjellë me eksplikim sipas hartës dhe shënimeve.</p>	<p>Vlerësim i punës individuale. Vlerësim i njohurive të fituara duke i mbështetur ato me argumentim dhe artikulim të shënimeve të fituara.</p>
		<p>9. Lëvizja natyrore dhe migrimet e popullsisë</p>	<p>1</p>	<p>Metoda e krahasimit dhe identifikimit të specifikave. bashkëvepruese dhe ilustruese. Përshkrim dhe eksplikim nga teksti në hartë. Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese. Analizë dhe sintezë e materialit, e përcjellë me eksplikim sipas hartës dhe shënimeve.</p>	<p>Vlerësim individual dhe në grup. Leximi dhe shpjegimi i punimit sipas kriterëve të paraqitura, përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve . Vlerësim i punës individuale. Vlerësim i njohurive të fituara duke i mbështetur ato me argumentim dhe artikulim të shënimeve të fituara.</p>

- Shpjegon faktorët që kanë kushtëzuar shkallën e lartë të natalitetit, mortalitetin e ulët dhe shtimin natyror të lartë, duke arsyetuar shkaqet kryesore të këtyre dukurive.
- Përshkruan veçoritë kryesore të popullsisë së Kosovës.

PLANI DYMUJOR

Nëntor - Dhjetor

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda mësimore: Gjeografi

Klasa: IX (nëntë)

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave brenda dymujorit

1. Kompetenca komunikim dhe të shprehur - Komunikues efektiv	I-1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8;
2. Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik	II- 1, 2, 4, 5, 7, 8;
3. Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm	III- 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8;
4. Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv	IV- 1, 4, 6;
5. Kompetenca personale - Individ i shëndoshë	V-
6. Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm	VI- 1, 7, 9

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

Konceptet:

Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë; Vendimmarrja dhe institucionet

Teksti: Gjeografia 9; Fletore pune 9, ATLAS GJEOGRAFIK

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit
Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> •Shpjegon strukturën gjinore, moshore, nivelin e shkollimit si dhe grupet kryesore të popullsisë sipas përkatësisë kombëtare e fetare. •Përshkruan faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në migrimet e popullsisë dhe fazat kryesore të tyre. •Analizon lidhjet e diasporës me vendlindjen, më parë dhe tani. •Dallon tipat kryesorë të vendbanimeve në Kosovë. •Shpjegon kriteret e ndarjes së vendbanimeve dhe funksionet e tyre. •Argumenton lidhjet mes industrializimit, urbanizimit dhe deagrarizimit •Dallon faktorët natyrorë dhe shoqërorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës. •Vlerëson rolin e kushteve historike, politike dhe shoqërore në zhvillimin ekonomik të Kosovës. •Vlerëson rolin e klimës në ekonomi e në shoqëri. •Vlerëson rolin e ujërave në zhvillimin ekonomik. •Shpjegon rëndësinë e ekonomisë bujqësore në ekonominë dhe zhvillimin e vendit. •Argumenton përshtatshmërinë e mjedisit gjeografik për zhvillimin e 	10. Vendbanimet	1	Parafolëse e mbështetur me eksplikim të hartës. Bashkëbiseduese dhe shpjegim grafikonësh me krahasim dhe identifikim.	Vlerësim individual i punës sipas listës së kontrollit.
		11. Testoni njohuritë: Veçoritë natyrore të Kosovës	1	Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese. Analizë dhe sintezë e materialit, hartës, grafikoneve dhe shënimeve.	Vlerësim i njohurive të fituara duke i mbështetur ato me argumentim dhe artikulum të shënimeve të fituara.
		12. Veçoritë ekonomike të Kosovës dhe faktorët e zhvillimit ekonomik	1	Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese. Analizë dhe sintezë e materialit, në formën e bashkëpunimit.	Vlerësim individual. Leximi dhe shpjegimi me hartë si dhe detyrave gjatë punës.
		13. Faktorët shoqërorë në zhvillimin e bujqësisë	1	Parafolëse e mbështetur me eksplikim të hartës. Bashkëbiseduese dhe shpjegim grafikonësh me krahasim dhe identifikim.	Vlerësim individual dhe në grup (bashkëpunimi). Leximi dhe përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve.
		14. Industria dhe energjetika	1	Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese. Analizë dhe sintezë e materialit, në formën e bashkëpunimit.	Vlerësim individual. Leximi dhe shpjegimi me hartë si dhe detyrave gjatë punës.
15. Komunikacioni, tregtia, zëjtaria dhe turizmi	1	Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese.	Vlerësim i detyrave që janë paraparë nga ars. Identifikimi me hartë dhe paraqitja (artikulimi) e tekstit për faktet		

<p><i>ekonomisë bujqësore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> •Analizon kushtet natyrore që ka Kosova për zhvillimin e bujqësisë. •Identifikon pasuritë natyrore që ka Kosova dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e industrisë dhe të ekonomisë në përgjithësi. •Shpjegon se si kanë ndikuar kushtet politike dhe shoqërore në zhvillimin industrial të Kosovës. •Dallon degët kryesore të industrisë së Kosovës, duke përshkruar veçoritë kryesore të tyre. •Përcakton në hartë qendrat dhe rajonet më të rëndësishme industriale të Kosovës. •Analizon faktorët që ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm industrial të Kosovës. •Krahason rrjetin rrugor diku dhe tani si dhe perspektivën për të ardhmen në zhvillimin e transportit •Analizon anët pozitive dhe negative të transportit automobilistik, hekurudhor dhe ajror dhe zhvillimin e tyre. •Shpjegon kushtet kryesore natyrore, kulturore dhe shoqërore që ndikojnë në zhvillimin e turizmit në Kosovë. •Identifikon zonat kryesore turistike, potencialin turistik që ka Kosova dhe shpjegon rolin e turizmit në ekonomi. •Vlerëson rolin e turizmit, tregtisë, transportit, shërbimeve dhe të artizanateve në zhvillimin ekonomik të Kosovës. •Analizon faktorët që ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm industrial të Kosovës. 	<p>16. Testim</p>	<p>1</p>	<p>Analizë dhe sintezë e materialit, në formën e bashkëpunimit.</p>	<p>dhe argumentet e fituara.</p>
<p><i>17. Prezantim i punimeve</i></p>	<p>17. Prezantim i punimeve</p>	<p>1</p>	<p>Vlerësim me shkrim sipas instrumentit vlerësues TESTIT.</p>	<p>Vlerësim me shkrim (përmbledhës) sipas nivelit të hierarkisë së dijes. 10 pyetje të kategorizuara sipas Taksonomisë së Blumit.</p>
<p><i>18. Regjioni Lindor i Kosovës</i></p>	<p>18. Regjioni Lindor i Kosovës</p>	<p>1</p>	<p>Prezantim i punimeve me anën e mjeteve teknologjike. Prezantim me <i>PowerPoint Presentation</i>. Punë në dyshe.</p>	<p>Vlerësimi sipas kriterëve që mësimdhënësi përpilon së bashku me nxënësit dhe listës së përshkrimit/arsyetimit.</p>
<p><i>Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese e mbështetur me demonstrim vizual në hartë..</i></p> <p><i>Analizë dhe sintezë e materialit, realizuar në formën e bashkëpunimit.</i></p>			<p>Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese e mbështetur me demonstrim vizual në hartë.. Analizë dhe sintezë e materialit, realizuar në formën e bashkëpunimit.</p>	<p>Vlerësim i punës në grupe dhe individuale. Vlerësim i njohurive të fituara duke i mbështetur ato me ilustrim dhe artikulum të shënimeve të fituara.</p>

PLANI DYMUIJOR

Janar - Shkurt - Mars

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda mësimore: Gjeografi

Klasa: IX (nëntë)

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave brenda dymujorit	
1. <i>Kompetenca komunikim dhe të shprehur - Komunikues efektiv</i>	I-1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8;
2. <i>Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik</i>	II- 1, 2, 4, 5, 7, 8;
3. <i>Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</i>	III- 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8;
4. <i>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - Kontribues produktiv</i>	IV- 1, 4, 6;
5. <i>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</i>	V-
6. <i>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</i>	VI- 1, 7, 9

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave	
RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.	
3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.	
3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.	
RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme	
4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.	
4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.	

Konceptet:	<i>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë; Vendimmarrja dhe institucionet</i>
-------------------	---

Teksti: Gjeografia 9; Fletore pune 9, ATLAS GJEOGRAFIK

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit
Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të	•Dallon regjionet kryesore të Kosovës (regj. Lindor dhe Perëndimor) duke i diferencuar në	19. Regjioni perëndimor i Kosovës	1	Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese e mbështetur me demonstrim	Vlerësim i punës në grupe dhe individuale. Vlerësim i njohurive të fituara

Kosovës	<i>bazë të veçorive natyrore dhe humane të tyre.</i>		vizual në hartë.. Analizë dhe sintezë e materialit, realizuar në formën e bashkëpunimit.	duke i mbështetur ato me ilustrim dhe artikulum të shënimeve të fituara.
		20. Testim i njohurive: Regjionet gjeografike të Kosovës	1	Vlerësim individual. Leximi dhe shpjegimi i punimit sipas kriterëve të paraqitura, përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve.
		21. Republika e Kosovës, veçoritë juridike, politike, administrative dhe gjeografike dhe sfidat drejt BE-së.	1	Vlerësim individual dhe në dysh (bashkëpunimi) Leximi dhe përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve.
		22. Shqipëria - pozita gjeografike	1	Vlerësim individual dhe në dysh (bashkëpunimi). Leximi dhe përdorimi i hartës, si dhe artikulimi i shënimeve të fituara si detërë në klasë.
Veçoritë natyrore të Shqipërisë	<ul style="list-style-type: none"> •Shpjegon veçoritë e përgjithshme natyrore të Shqipërisë. •Dallon karakteristikat kryesore gjeotektonike. •Përshkruan përbërjen kryesore të ndërtimit gjeologjik të Shqipërisë. •Dallon njësitë kryesore relievore që përbëjnë territorin e vendit. •Analizon shtrirjen dhe ndikimin e klimës nga jugu në veri dhe nga perëndimi në lindje të vendit. •Dallon objektet kryesore ujore (detet, liqenet, lumenjtë, etj.) •Përshkruan përhapjen dhe plleshmërinë e tokave •Shpjegon përhapjen e bimësisë e 	23. Veçoritë natyrore të Republikës së Shqipërisë	1	Vlerësim individual dhe në dysh (bashkëpunimi) Leximi dhe përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve.
		24. Testoni njohuritë: SHQIPËRIA	1	Vlerësim i detyrave që janë paraparë nga ars. Identifikimi me hartë dhe paraqitja (artikulimi) e tekstit për faktet dhe argumentet e fituara.
		25. Popullsia e Shqipërisë	1	Vlerësim individual dhe në dysh (bashkëpunimi). Leximi dhe përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve të fituara si detërë në klasë.

<p>të shtazëve dhe faktorët ndikues të përhapjes.</p> <ul style="list-style-type: none"> •Shpjegon veçoritë e përgjithshme natyrore të Shqipërisë •Dallon karakteristikat kryesore gjeotektonike •Përshkruan përbërjen kryesore të ndërtimit gjeologjik të Shqipërisë •Dallon njësitë kryesore relievore që përbëjnë territorin e vendit •Analizon shtrirjen dhe ndikimin e klimës nga jugu në verë dhe nga perëndimi në lindje të vendit •Dallon objektet kryesore ujore (detërat, liqejt, lumenjtë, etj.) •Përshkruan përhapjen dhe plleshmërinë e tokave •Shpjegon përhapjen e bimësisë dhe të shtazëve dhe faktorët ndikues të përhapjes. 	<p>26. Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë</p>	1	<p>eksplikimit të teksteve dhe hartës. Analizë dhe sintezë e materialit, në formën e bashkëpunimit.</p>	<p>Vlerësim i detyrave të realizuara në klasë dhe leximi dhe interpretimi i hartës.</p>
	<p>27. Veprimtari praktike: Ekonomia e Shqipërisë</p>	1	<p>Parafolëse e mbështetur me eksplikim të hartës.</p>	<p>Vlerësim i detyrave të realizuara në klasë sipas kriterëve të hartuara së bashku me nxënësit.</p>
	<p>28. Testim i dytë</p>	1	<p>Bashkëbiseduese dhe shpjegim grafikonësh me krahasim dhe identifikim.</p>	<p>Vlerësim me shkrim (përmbledhës) sipas nivelit të hierarkisë së dijes.</p>
	<p>29. Prezantim i punimeve: Republika e Shqipërisë</p>	1	<p>Ushtrime me anën e hulumtimit dhe përshkrimit.</p>	<p>Vlerësim me shkrim sipas instrumentit vlerësues TESTIT.</p>
				<p>Prezantim me anën e mjeteve teknologjike. Prezantim me <i>PowerPoint Presentation</i>. Punë në dyshe.</p>

Tema	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore
<p>Veçoritë shoqërore - ekonomike të Shqipërisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> •Analizon karakteristikat kryesore të popullsisë së Shqipërisë (natalitetin, mortalitetin, shtimin natyror, strukturën etnike, moshore, gjinore dhe përkatësinë fetare). •Krahason ngjashmëritë e tkurrjes së territoreve shqiptare në jug të vendit sikur ato në veri të Kosovës dhe verilindje apo edhe veriperëndim të Shqipërisë . •Identifikon pasuritë natyrore të Shqipërisë dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik.

PLANI DYMUIJOR
Prill - Maj - Qershor

Fusha e kurrikulës: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda mësimore: Gjeografi

Klasa: IX (nëntë)

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave brenda dymujorit	
1. <i>Kompetenca komunikim dhe të shprehur - komunikues efektiv</i>	I-1, 2, 3, 4, 5, 6,7, 8;
2. <i>Kompetenca të menduarit - Mendimtar kreativ dhe kritik</i>	II- 1, 2, 4, 5, 7, 8;
3. <i>Kompetenca të mësuarit për të nxënë - Nxënës i suksesshëm</i>	III- 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8;
4. <i>Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis – Kontribues produktiv</i>	IV- 1, 4, 6;
5. <i>Kompetenca personale - Individ i shëndoshë</i>	V-
6. <i>Kompetenca qytetare - Qytetar i përgjegjshëm</i>	VI- 1,7,9

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave	
RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.	
3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.	
3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.	
RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme	
4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.	
4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.	

Konceptet:	<i>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë; Vendimmarrja dhe institucionet</i>
-------------------	---

Teksti: Gjeografia 9; Fletore pune 9, ATLAS GJEOGRAFIK

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit
Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë	<ul style="list-style-type: none"> •Vlerëson potencialin turistik të Shqipërisë (zonën bregdetare, zonat tjera malore dhe bukuritë e veçanta natyrore dhe kulturore) •Dallon fushat kryesore me potencial bujqësor dhe me ndikim në ekonominë e vendit. •Dallon fazat kryesore të zhvillimit socio-ekonomik dhe politiko-kulturor të Shqipërisë, që nga pavarësia e saj deri në ditët e sotme. •Analizon ndryshimin e madh në procesin politik, ekonomik dhe të migrimeve në fillimin e viteve të '90-ta të shekullit XX. •Analizon shtrirjen e vendbanimeve kryesore në raport me veçoritë relievore të Shqipërisë. •Dallon regjionet gjeografike dhe tiparet kryesore të tyre. •Analizon ecurinë dhe sfidat e Shqipërisë, drejt anëtarësimit në BE. 	30. Transporti, tregtia e jashtme dhe turizmi.	1	Parafolëse, bashkëbiseduese dhe krahasuese.	Vlerësim i punës (detyrave të klasës) dhe aktivitetit individual.
		31. Regjioni i Ultësirës Perëndimore	1	Metoda e krahasimit dhe e identifikimit të specifikave. Analizë dhe bashkëvepruese. Përshkrim dhe ekspikim nga teksti në hartë. Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese.	Vlerësim i njohurive të fituara duke i mbështetur ato me ilustrim dhe artikulum të shënimeve të fituara.
		32. Krahina Malore Qendrore	1	Parafolëse e mbështetur me ekspikim të hartës. Bashkëbiseduese dhe shpjegim grafikonësh me krahasim.	Vlerësim i njohurive të fituara duke i mbështetur ato me ilustrim dhe artikulum të shënimeve të fituara.
		33. Krahina Malore Veriore dhe Krahina Jugore	1	Ushtrime me diagram -analizë dhe sintezë e materialit, e përcjellë me ekspikim sipas hartës dhe shënimeve.	Vlerësim i detyrave të realizuara në klasë dhe shpjegim/leximi i hartës.
		34. Veprimtari praktike: Regjionet gjeografike të Shqipërisë	1	Metoda parafolëse dhe bashkëbiseduese e mbështetur me demonstrim vizual në hartë.. Analizë dhe sintezë e materialit, realizuar në formën e bashkëpunimit.	Vlerësim i detyrave të realizuara në klasë dhe shpjegim/leximi i hartës.
Veçoritë shoqërore ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.	<ul style="list-style-type: none"> •Dallon veçoritë kryesore humane (ekonomike, demografike, urbane) të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi. •Dallon degët kryesore ekonomike 	35. Maqedonia Veriore	1		Vlerësim individual dhe në grup. Vlerësim i aktiviteteve në klasë, përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve.

<p>të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi</p> <p>•Shpjegon ndikimin e kushteve historike, politike dhe shoqërore në zhvillimin e ekonomisë dhe të degëve kryesore të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.</p> <p>•Shpjegon pozitën e shqiptarëve në ish-Jugosllavi.</p> <p>•Dallon strukturën nacionale dhe fetare të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.</p> <p>•Vlerëson kontekstin historik të ngjarjeve kryesore dhe dëmtimin e truallit dhe etnikumit të shqiptarëve deri më sot.</p> <p>Shpjegon për shtrirjen e shqiptarëve jasht territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, duke e përdor hartën.</p>	<p>36. Mali i Zi</p>	<p>1</p>	<p>Parafolëse e mbështetur me eksplikim të hartës. Bashkëbiseduese dhe shpjegim grafikonësh me krahasim.</p>	<p>Vlerësim individual dhe në dysh (bashkëpunimi). Leximi dhe përdorimi i hartës si dhe artikulimi i shënimeve .</p>
	<p>37. Serbia</p>	<p>1</p>	<p>Mësimi realizohet me metodën e bashkëpunimit dhe eksplikimit të teksteve dhe hartës. Punë individuale me nxënësin.</p>	<p>Vlerësim i detyrave që janë paraparë nga ars. Identifikimi me hartë dhe paraqitja (artikulimi) e tekstit.</p>
	<p>38. Testim i tretë me shkrim</p>	<p>1</p>	<p>Vlerësim me shkrim sipas instrumentit vlerësues TESTIT.</p>	<p>Vlerësim me shkrim (përmbledhës) sipas nivelit të hierarkisë së dijes. 10 pyetje të kategorizuara sipas Taksonomisë së Blumit.</p>

Tema	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore
<p>Veçoritë e përgjithshme natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> Shpjegon karakteristikat themelore natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi, duke përfshirë faktorët: ndërtimi gjeologjik, njësitë kryesore morfologjike, objektet kryesore hidrografike komponentët specifike dhe përcaktuese të klimës, dhe tiparet e biodiversitetit e këtyre vendeve, me theks të veçantë në pjesën e territoreve ku jetojnë shqiptarët.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 01

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedis Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema:

-Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia e Gadishullit Ballkanik dhe shteteve përbërëse të tij

- Veçoritë e përgjithshme fiziko-gjeografike të Gadishullit Ballkanik

Rezultati i të nxënit të temës

-Shpjegon pozitën gjeografike të Gadishullit Ballkanik dhe veçoritë e kësaj pozite, përparësitë dhe mangësitë eventuale të kësaj pozite.
 -Përshkruan pozitën gjeografike të Kosovës dhe lidhjen e saj rrugore nëpërmjet luginave lumore dhe qafave malore me vendet fqinje.
 -Analizon pozitën gjeografike të Shqipërisë, duke veçuar përparësitë e saj (dalja në Detin Adriatik dhe Jon si dhe lidhjet tani më të mira rrugore me Kosovën dhe vendet fqinje).
 -Dallon shtetet përbërëse të Gadishullit Ballkanik, i krahason ato mes vete dhe me shtetet përtej tyre, pozitën gjeografike në Gadishull.
 -Analizon pozitën gjeografike të shteteve fqinje të Kosovës, me theks vazhdimësinë territoriale e etnike të popullsisë shqiptare: Kosovë - Maqedonia e Veriut, Serbi, Mali i Zi.
 -Dallon karakteristikat e përgjithshme esenciale natyrore përbërëse të Gadishullit Ballkanik.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvlerësinë e tyre.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore të Gadishullit Ballkanik

Fjalët kyçe: Gadishulli Ballkanik, Deti Mesdhe, Dinaridet, klimë e llojllojshme, terrenet karstike, bimësi e pasur.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

Sqarim: Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore nuk paraqiten, nëse të njëjtat janë përfshirë te "Rezultatet e të nxënit të temës". Kjo bëhet me arsyen që të mos përsëriten/ripërshkruhen dhe të ngarkohet planifikimi. Nëse mësimdhënësi mendon që i duhen edhe rezultate shtesë për të specifikuar aktivitetin dhe punën e nxënësve gjatë orës, atëherë ai paraqet "Rezultatet e të nxënit për orë mësimore".

1. Tregon rëndësinë e pozitës gjeografike për gadishullin Ballkanik në raport me regjionet e tjera.
2. Interpreton me hartë veçoritë fiziko-gjeografike të Gadishullit Ballkanik dhe tregon pozitën gjeografike të tyre.
3. Identifikon shtetet e Gadishullit Ballkanik dhe shpjegon pozitën e tyre përmes hartës politike.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Tregon të paktën tre përparësi të Gadishullit Ballkanik ndaj gadishujve të tjerë;
2. Identifikon të paktën tre male të reja dhe të vjetra të Gadishullit Ballkanik;
3. Dallon të paktën tre ultësirat kryesore të Gadishullit Ballkanik;
4. Liston shtetet e Gadishullit Ballkanik sipas madhësisë territoriale.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Punë në grupe "Xhiksou"

Mësimdhënësi ndan nxënësit në tri grupe (grupe familjare), ku secili nxënës ka një numër 1, 2, 3. Pasi

nxënësit të jenë përcaktuar sipas numrave, bashkohen njëshat bashkë (1), dyshat bashkë (2) dhe treshat bashkë (3) që njihen si “grupet e ekspertëve”.

Mësimdhënësi i jep secilit grup nga një detyrë (fleta me pyetje dhe detyra) që janë pjesë e tekstit që do e shtjellojnë. Nxënësit lexojnë pjesën e caktuar për kohë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar. Pas “ekspertizës”, nxënësit kthehen në grupet amë (familjare) dhe për një kohë të shkurtër i shpjegojnë njëri-tjetrit njohuritë e tyre për njësinë. Pjesët me ngjyra në libër: “faktet” dhe “Gjeografia për kureshtarë” dhe “bota bimore dhe shtazore” i lexojnë të gjitha grupet. Aktiviteti ndahet sipas kohës: Pjesa e parë 5 minuta, pjesa e dytë 25 minuta dhe pjesa e tretë 15 minuta.

Kjo teknikë mund të përdoret në tria etapat e orës. Nëse modifikohet mund të përdoret vetëm në pjesën shtjelluese të orës.

Pjesa e dytë: (punë në grupe).

Grupi 1 (pozita gjeografike dhe bota bimore dhe shtazore)

-Identifikoni detet që lagin brigjet e Gadishullit Ballkanik.

-Cilat vende i lidh rruga “Korridori VIII”?

-Cilat pjesë gjeografike njihen si kufiri verior i G. Ballkanik?

-Si e mori emrin Gadishulli Ballkanik?

Detyra: Krijoni një tabelë me shtetet e Gadishullit Ballkanik dhe renditni sipas madhësisë.

Grupi 2 (relieve dhe bota bimore dhe shtazore)

-Cilat janë vargmalet kryesore në Gadishullin Ballkanik?

-Cila është maja malore më e lartë në G. Ballkanik?

-Në atlas, identifikoni fushat periferike dhe ato ndërmallore sipas emrave të paraqitur në libër (rretho emrat e tyre me laps).

Detyra: Përshkruani me fjalët tuaja bregdetin e Gadishullit Ballkanik.

Grupi 3 (klime dhe bota bimore dhe shtazore)

-Cilët janë faktorët që ndikojnë në klimën e G. Ballkanik?

-Tregoni disa nga erërat më të njohura në G. Ballkanik?

-Cila pjesë e gadishullit ka më shumë reshje?

-Tregoni llojet e klimës që dominojnë në hapësirat e G. Ballkanik?

Detyra: Krijoni një tabelë me tre shtylla për tri llojet e klimave kryesore dhe paraqitni specifikat për secilën klimë.

Grupi 4 (hidrografia dhe bota bimore dhe shtazore)

Detyra: Punoni një tabelë dhe listoni ujëmbledhësit dhe lumenjtë përkatës.

-Cili është pellgu lumor më i madh në G. Ballkanik?

-Identifikoni në atlas të paktën pesë liqenet më të njohura në G. Ballkanik.

-Nëpër cilat shtete të G. Ballkanik kalon Danubi?

-Cilat janë llojet e tokave më të përhapura në G. Ballkanik?

-Grupet në fund të pjesës së dytë dorëzojnë detyrën në grup te mësimdhënësi.

Pjesa e tretë: (reflektim në grupe). Të lexohen punimet/detyrat e grupeve, gjithnjë duke i përcjellë me hartë.

Nxënësit e tjerë, pasi dëgjojnë prezantimin, mund të drejtohen me pyetje për informacion shtesë nëpërmjet udhëheqësit të grupit. Gjithashtu, edhe mësimmhënësi, për të kuptuar më shumë, mund t'ju drejtohet me pyetje, gjithnjë duke pasur parasysh kohën që kemi në dispozicion.

Mësimmhënësi i vlerëson nxënësit si grup dhe si punë individuale, gjithnjë duke i respektuar kriteret e parashtruara. Mbani shënime në listën e kontrollit ose ndonjë instrument specifik më të përshtatshëm për punën tuaj gjatë vlerësimit të vazhdueshëm.

Detyrë shtëpie: Plotëso në fletore të punës: GADISHULLI BALLKANIK - VEÇORITË FIZIKO-GJEOGRAFIKE.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimmhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimmhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

Vërejtje: Në planifikimin e orës mësimore është paraqitur koha për secilën pjesë të orës. Mësimmhënësi mund ta përshtatë kohën sipas hapësirës dhe rrethanave specifike që ka klasa.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


No: 02

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Specifikat demografike, kulturore, ekonomike dhe politiko-administrative të Gadishullit Ballkanik

Rezultati i të nxëniet të temës

- Dallon disa tipare ekonomike (industriale, bujqësore, turistike, etj.) të Ballkanit.
- Dallon shtetet përbërëse të regjionit ballkanik.
- Identifikon gjuhët kryesore dhe elementet e tjera etnokulturore të popullsisë dhe shtrirjen e tyre në Gadishullin Ballkanik.
- Dallon shtrirjen hapësinore të feve më mbizotëruese në Ballkan.

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: GADISHULLI BALLKANIK - VEÇORITË SHOQËRORE-EKONOMIKE

Fjalët kyçe: Ballkani, popullsia, struktura etnike, zhvillimi ekonomik

Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore:

Sqarim: Rezultati/et e të nxënët për orë mësimore nuk paraqiten nëse të njëjtat janë përfshirë te "Rezultatet e të nxënët të temës". Kjo bëhet me arsyen që të mos përsëriten/ripërkruhen dhe të ngarkohet planifikimi. Nëse mësimdhënësi mendon që i duhen edhe rezultate shitesë për të specifikuar aktivitetin dhe punën e nxënësve gjatë orës, atëherë ai paraqet "Rezultatet e të nxënët për orë mësimore".

1. Identifikon popujt kryesorë që jetojnë në Gadishullin Ballkanik sipas shteteve ose hapësirave territoriale në hartë.
2. Evidenton pasuritë kryesore natyrore në të cilat mbështetet zhvillimi ekonomik i shteteve të Gadishullit Ballkanik.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Identifikon me hartë të paktën pesë shtete ku dominon popullsia sllave;
2. Tregon shtetet ku dominon besimi Islam, krishtere ortodokse dhe katolike;
3. Numëron të paktën pesë pasuri natyrore të G. Ballkanik.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Punë individuale "galeria".

Mësimdhënësi, para nxënësve, paraqet disa flamuj të shteteve të Gadishullit Ballkanik dhe kërkon nga nxënësit t'i identifikojnë shtetet dhe popujt që jetojnë në ato shtete dhe territore.



Ky aktivitet i fillimit të orës mund të bëhet me letra ngjitëse me ngjyra, ku nxënësi mund të shënojë emrin e shtetit dhe ta ngjitë në hartën e murit ose mësimdhënësi mund të sjellë flamuj ngjitës.

Aktiviteti ndahet sipas kohës: Pjesa e parë 5 minuta, pjesa e dytë 25 minuta dhe pjesa e tretë 15 minuta.

Pjesa e dytë: (punë në grupe).

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe pune (3-5 nxënës). Secilit grup i jep një detyrë të caktuar në një letër. Nxënësit vetë organizohen duke i ndarë detyrat dhe pjesët e leximit.

Grupi 1

- Identifikoni shtetet e Gadishullit Ballkanik dhe regjionet gjeografike në kufijtë natyrorë.
- Krijoni një listë me popujt më të mëdhenj në G. Ballkanik?

- Kush ishin banorët më të hershëm në G. Ballkanik?
- Kush është shteti me dendësinë më të madhe dhe me dendësinë më të vogël në G. Ballkanik?

Grupi 2

- Ndani shtetet e Gadishullit Ballkanik sipas religjionit dominues?
- Me cilat resurse minerale shquhet G. Ballkanik?
- Cilat janë portet më të mëdha detare në Gadishullin Ballkanik?
- Identifikoni shtetet me turizmin më të zhvilluar dhe tregoni të paktën një qendër turistike.

Grupi 3

- Tregoni hapësirat me popullsi shqiptare në shtetet e G. Ballkanik.
- Kur e shpalli pavarësinë Republika e Kosovës?
- Cilat janë ndryshimet e mëdha gjeopolitike të cilat ndodhën në rajon, në fund të shekullit XX?
- Identifikoni shtetet ballkanike që nuk kanë dalje në det.

Pjesa e tretë: (reflektim në grupe)

Grupet prezantojnë para klasës (3 minuta) punimet/detyrat e tyre, gjithnjë duke i përcjellë me hartë. Nxënësit e tjerë pasi dëgjojnë prezantimin, mund të drejtohen me pyetje për informacion shtesë nëpërmjet udhëheqësit të grupit.

Mësimdhënësi i vlerëson nxënësit si grup dhe si punë individuale, gjithnjë duke i respektuar kriteret e parashtruara.

Detyrë shtëpie: Plotëso fletoren e punës: GADISHULLI BALLKANIK - VEÇORITË SHOQËRORE-EKONOMIKE

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

Vërejtje: në planifikimin e orës mësimore është paraqitur koha për secilën pjesë të orës. Mësimdhënësi mund të përshtatë kohën sipas hapësirës dhe rrethanave specifike që ka klasa.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 03

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Kosovës

Rezultati i të nxënës të temës

- Argumenton se përmes cilave tërësi morfologjike (luginave, luginave grykore e qafave malore) lidhet Kosova me vendet përreth dhe me cilat shtete ka kufij natyrorë dhe etnikë.
- Shpjegon veçoritë kryesore të ndërtimit gjeologjik.
- Dallon llojet kryesore të shkëmbinjve dhe mineraleve të dobishme prezente në truallin e Kosovës.
- Dallon tërësitë kryesore relievo të Kosovës.

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: KOSOVA – pozita gjeografike

Fjalët kyçe: Kosova, pozita gjeografike, lidhjet kufitare, forma dhe madhësia e territorit.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

1. Interpreton me hartën e Kosovës pozitën gjeografike në Gadishullin Ballkanik dhe Evropë.
2. Shpjegon lidhjet komunikative të Kosovës me vendet përreth dhe më gjerë.
3. Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Kosovës në raport me rrugët ndërkombëtare.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpiqen të bashkohen me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gathtë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë "Rezultateve të orës mësimore".

Shembull:

1. Identifikon me hartë të gjitha shtete me të cilat kufizohet Kosova;
2. Tregon të paktën katër përparësi të pozitës së mirë gjeografike që ka Kosova;
3. Shpjegon me hartë hapësirat me popullsi shqiptare, jashtë kufijve të Kosovës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: punë individuale me hartë.

Mësimdhënësi në pjesën hyrëse të orës, para nxënësve paraqet hartën e G. Ballkanik dhe të Evropës, dhe kërkon që të identifikohet hapësira sovranë e territorit të Kosovës.

Gjithashtu mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të përdorin atlasat individuale dhe të identifikojnë shtetet që kufizohen me Kosovën.

Në cilin gadishull gjendemi? Cila është pozita gjeografike sipas anëve të horizontit në Ballkan dhe Evropë?



Pjesa e dytë: Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e INSERTIT: (v) - informacion i njohur, (+) - informacion i ri, (-) - informacion që ndryshon nga ai që e di, (?) - sqarime për informacion të paqartë. Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informacione ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetje nga mësimdhënësi, të shënuara nga nxënësit.

v	+	-	?
(v) - Informacion i njohur	(+) - Informacion i ri	(-) - Informacion që ndryshon nga ai që di	(?) - sqarime për informacionin

Pjesa e tretë: Punë individuale.

Në pjesën e tretë, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të plotësohet pjesa e pozitës gjeografike në fletoren e punës. Puna e nxënësve duhet të jetë individuale dhe pa ndihmën e teksteve.

Detyra:

Shëno emrat e shteteve në hapësirat e tyre përkatëse.


Shëno emrat e deteve në pjesën e tyre përkatëse.

Shëno emrat e kryeqyteteve për shtetet përkatëse.

Shëno shtetet në të cilat pjesë e popullsisë janë edhe shqiptarët.

...

Mësimdhënësi viziton nxënësit nëpër banka dhe kontrollon njohuritë e tyre gjatë plotësimit të detyrës, duke kërkuar të interpretojnë hartën.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimitdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimitdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 04

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Kosovës

Rezultati i të nxëniet të temës

- Argumenton se përmes cilave tërësi morfologjike (luginave, luginave grykore e qafave malore) lidhet Kosova me vendet përreth dhe me cilat shtete ka kufij natyrorë dhe etnikë.
- Shpjegon veçoritë kryesore të ndërtimit gjeologjik.
- Dallon llojet kryesore të shkëmbinjve dhe mineraleve të dobishme në truallin e Kosovës.
- Dallon tërësitë kryesore relievore të Kosovës.

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës: _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore, duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: NDËRTIMI GJEOLOGJIK DHE RELIEVI I TERRITORIT TË KOSOVËS

Fjalët kyçe: Kosova, gjeologjia, tektonika, shkëmbinjte, orogjenezat, kuaternari.

Rezultati/et e të nxëniet për orë mësimore:

1. Kupton ndërtimin gjeologjik dhe të shkëmbinjve sipas kohës së krijimit në hapësirën e Kosovës.
2. Shpjegon me hartë shtrirjen e maleve dhe të fushave në Kosovë dhe tregon mënyrën e krijimit të relievit të Kosovës.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë "Rezultateve të orës mësimore".

Shembull:

1. Shpjegon në hartë pesë zonat gjeologjike-tektonike të Kosovës;
2. Tregon se ku gjenden formacionet e paleozoikut;
3. Identifikon në hartë tri majat më të mëdha malore në Kosovë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare:

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Punë në grupe "Xhiksou".

Mësimdhënësi ndan nxënësit në tri grupe (grupe familjare), ku secili nxënës ka një numër 1, 2, 3 dhe 4. Pasi nxënësit të jenë përcaktuar sipas numrave, bashkohen njëshat bashkë (1), dyshat bashkë (2) dhe treshat bashkë (3) që njihen si "grupet e ekspertëve".

Mësimdhënësi i jep secilit grup nga një detyrë (fleta me pyetje dhe detyra) që janë pjesë e tekstit që do e shtjellojnë. Nxënësit lexojnë pjesën e caktuar për kohë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar. Pas "ekspertizës", nxënësit kthehen në grupet amë (familjare) dhe për një kohë të shkurtër i shpjegojnë njëri-tjetrit njohuritë e tyre për njësinë. Pjesët me ngjyra në libër: "faktet" dhe "Gjeografia për kureshtarë" dhe "bota bimore dhe shtazore" i lexojnë të gjitha grupet.

Aktiviteti ndahet sipas kohës: Pjesa e parë 5 minuta, pjesa e dytë 25 minuta dhe pjesa e tretë 15 minuta.

Kjo teknikë mund të përdoret në tri etapat e orës. Nëse modifikohet mund të përdoret vetëm në pjesën shtjelluese të orës.

Pjesa e dytë: (punë në grupe)

Grupi 1 (Ndërtimi gjeologjik i Kosovës)

- Sa zonave gjeologjike-tektonike i takon Kosova dhe cilat janë ato?
- Në cilën pjesë të Kosovës gjenden shkëmbinjtë më të vjetër?
- Përshkruani formacionet e kenozoikut dhe tregoni përhapjen e tyre.
- Tregoni formacionet e mesozoikut dhe shtrirjen e tyre.

Grupi 2 (Malet deri te Bjeshkët e Nemuna)

- Si ndahen malet nga aspekti i moshës në Kosovë?
- Cilat janë majat malore më të larta në Kosovë?
- Tregoni pikën më të ulët në relievin e Rep. së Kosovës.
- Sa është lartësia mesatare mbidetare në Kosovë?
- Cilat janë malet periferike dhe qendrore të Kosovës?
- Përdorni hartën dhe tregoni pozitën gjeografike të Bjeshkëve të Nemuna si dhe shënjoni të paktën tri majet malore kryesore.

Grupi 3 (Malet e Hasit me Pashtrikun - Kopaoniku dhe Rogozna)

- Përdorni hartën dhe tregoni pozitën gjeografike të maleve të Hasit si dhe shënjoni majen malore kryesore (Pashtrikun).
- Përdorni hartën dhe tregoni pozitën gjeografike të maleve të Sharrit, Koritnikut, Karadakut, Maleve Lindore të Kosovës dhe Kopaonikut e Rogoznës.
- Identifikoni dhe shënjoni lartësitë e majave malore kryesore të maleve të lartpërmendura.


Grupi 4 (Fushëgropat deri në fund)

- Tregoni lartësinë mbidetare të fushëgropave të Kosovës dhe sa për qind të territorit përfshijnë.
- Cilat janë dimensionet e Rrafshit të Dukagjinit dhe të Fushës së Kosovës?
- Identifikoni në hartën e punës fushëgropat e Kosovës: të Dukagjinit, të Kosovës, të Anamoravës, të Llapit dhe të Drenicës.
- Cilat janë shpellat më të njohura në Kosovë?

Grupet në fund të pjesës së dytë dorëzojnë detyrën në grup te mësimdhënësi.

Pjesa e tretë: Reflektim në grupe

Të lexohen punimet/detyrat e grupeve, gjithnjë duke i përcjellë me hartë. Nxënësit e tjerë pasi dëgjojnë prezantimin, mund të drejtohen me pyetje për informacion shtesë nëpërmjet udhëheqësit të grupit. Gjithashtu edhe mësimdhënësi për të



kuptuar më shumë mund t'ju drejtohet me pyetje, gjithnjë duke pasur parasysh kohën që kemi në dispozicion.

Mësimdhënësi i vlerëson nxënësit si grup dhe si punë individuale, gjithnjë duke i respektuar kriteret e parashtruara. Mbani shënime në listën e kontrollit ose ndonjë instrument specifik më të përshtatshëm për punën tuaj gjatë vlerësimit të vazhdueshëm.

Detyrë shtëpie: Plotëso në fletore të punës pjesën e “Ndërtimi gjeologjik dhe relievi”.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) dhe vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 05

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4

Klasa: IX

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Kosovës

Rezultati i të nxënit të temës

-Dallon veçoritë klimatike dhe shtrirjen e përafërt të tyre në territorin e Republikës së Kosovës

-Diferencon elementet kryesore klimatike mes rrafshit të Dukagjinit dhe të Kosovës.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klima

Fjalët kyçe: Kosova, klima, faktorët klimatikë, reshjet, temperatura, erërat.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Analizon faktorët klimatikë në Kosovë sipas elementeve klimatike nëpër stacionet kryesore në Kosovë.
2. Vlerëson rëndësinë e klimës për veprimtari të ndryshme ekonomike në Rep. E Kosovës.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Numëron faktorët klimatikë të klimës në Kosovë;
2. Tregon të paktën dy dallime të klimës në mes Regjionit Lindor dhe Perëndimor;
3. Liston pesë dobi të klimës kontinentale për bujqësinë e vendit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Punë individuale (klaster).

Në pjesën hyrëse të orës, mësimitdhënësi në qendër të tabelës shkruan “Klima e Kosovës” dhe kërkon nga nxënësit të shprehin mendimet (informacionin) në formë të degëzimeve që lidhen me klimën në Kosovë.

Mësimitdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të papërshtatshme për njësinë “Klima e Kosovës”.



Vërejtje: Klasteri nuk është plotësuar me arsyen që nuk mund të paragjykojmë se çfarë mund të shprehin nxënësit gjatë një ore mësimore.

Pjesa e dytë: Punë individuale me “Ditarin dypjesësh”.

Në pjesën e dytë të orës, mësimitdhënësi ndan tabelën në dy shtylla. Në shtyllën e parë, mësimitdhënësi shënon disa fjalë kyçe që janë pjesë e njësisë që do të zhvillohet dhe kërkon nga nxënësit, që duke lexuar tekstin “Klima e Republikës së Kosovës”, të bëjnë përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë:

<i>Citati</i>	<i>Komenti që jepet nga nxënësit</i>
<i>Klimë</i>	
<i>Moti</i>	
<i>Diellosja</i>	
<i>Erërat</i>	
<i>Temperatura e ajrit</i>	
<i>Faktorët klimatikë në Kos.</i>	
<i>Reshjet në Kosovë</i>	
<i>Klima kontinentale</i>	
<i>Luginat lumore</i>	

Pjesa e tretë: Punë individuale me fletore pune.

Në mënyrë individuale, plotëso fletoren e punës te pjesa e Klimës pa përdorur librin.

1. Faktorët klimatikë që përcaktojnë klimën e Kosovës janë:

2. Në cilin muaj, kanë më së afërmi orë me dielli Prishtina dhe Prizreni?

3. Pse Prizreni dhe Peja kanë më pak orë me diell se Prishtina?

4. Vlerëson rolin e klimës për veprimtaritë e ndryshme ekonomike në Republikën e Kosovës.

5. Pse temperatura e ajrit është më e lartë në fushën e Dukagjinit se në fushën e Kosovës?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimsdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerësojë punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimsdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 06

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4

Klasa: IX

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Kosovës

Rezultati i të nxënësit të temës

-Shpjegon karakteristikat themelore hidrografike të Republikës së Kosovës.

-Identifikon pellgjet kryesore lumore në Kosovë.

-Dallon tipat gjenetikë të liqeneve dhe shtrirjen e tyre në Kosovë.

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Hidrografia

Fjalët kyçe: Kosova, hidrografia, sistemet lumore, pellgjet detare, liqenet, bifurkacioni

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Shpjegon rrjetin hidrografik të Kosovës, sistemet lumore dhe pellgjet detare në atlasin gjeografik.

2. Vlerëson rëndësinë e ujit për veprimtaritë e ndryshme ekonomike në Republikën e Kosovës.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Rreshton në tabelë lumenjtë sipas pellgjeve detare.
2. Tregon të paktën pesë dobi të ujrave rrjedhëse për shoqërinë njerëzore.
3. Liston liqenet e Kosovës sipas madhësisë së vëllimit të ujit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim

Filloni diskutimin duke kërkuar nga nxënësit që të shprehin emra lumenjsh ose liqenesh në Kosovë. Lumenj lokalë... specifikat e tyre....

Mësimdhënësi mund të vazhdon me pyetje nëse nevojitet:

Cili është liqeni më i afërt i vendit ku ju jetoni?

Çfarë origjine të krijimit ka ky liqen?

Cili është lumi që vizitoni më së shpeshti?

...

Mësimdhënësi gjatë diskutimit, shënon emrat e lumenjve ose fjalët kyçe që mund t'u referohet kohë pas kohe gjatë zhvillimit të mësimi. Kjo shërben si pjesë motivuese për nxënësit kur u përputhen njohuritë me atë që e kanë ditur më herët.

Shembull: Ereniku, liqeni i Radoniqit, liqeni i Ujmanit, Toplluha, Drini, ndotja e lumenjve, uji i pijës.

Pjesa e dytë: Drejtim në lexim me zë.

Në pjesën e dytë, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit (njëri nga ata) ose lexon vetë me zë pjesën e njësish (paragrafin). Kur përfundon leximi, diskutohet për atë se çka u lexua, gjithnjë duke shpjeguar me hartë.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet, varësisht nga natyra e përmbajtjes:
 - Në Kosovë hasen edhe akuiferët artezianë (me presion). Në cilat vende? (identifikoni në hartë)
 - Cilat janë disa burime karstike në Kosovë? (shënoni në tabelë)
- Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës/paragrafit 2, 3...
 - Cili është burimi më i madh?
 - Cilat janë vendburimet më të njohura të ujrave minerale në Kosovë?
 - Si quhet "kyçi hidrografik" i Gadishullit Ballkanik?
 - Tregoni së ç'kuptoni me BIFURKACION dhe ku ndodhet kjo dukuri në Kosovë?
 - Pse fenomeni natyror i BIFURKACIONIT në Kosovë është artificial (arsyetoni)?
 - Cilat janë karakteristikat e lumenjve kodrinoro-malorë dhe fushorë?
 - Sa për qind e ujërave rrjedhin në pjesën perëndimore dhe sa në pjesën lindore?
 - Tregoni katër sistemet kryesore lumore të Kosovës.
 - Cilat janë ujëmbledhësit e Kosovës dhe tregoni sasinë në përqindje.
 - Cilat janë degët kryesore të Drinit të Bardhë?

-Tregoni 3 karakteristika të lumit Ibër, Morava e Binçës, lumit Lepenc?

-Si i kemi ndarë liqenet për nga origjina në Kosovë (listoni në tabelë)?


-Tregoni disa lumenj artificialë në Kosovë dhe cili nga këta është më i madhi?

- Pas leximit të fundit, nxënësve, mësimitdhënësi duhet t'u japë mundësi që ata të flasin me njëri-tjetrin e jo përmes tij. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës. Në fund, mësimitdhënësi pyet nxënësit. A ka Kosova potencial hidroenergjetik?

Pjesa e tretë: Në pjesën e tretë, mësimitdhënësi kërkon nga nxënësit që të plotësohet pjesa e pozitës gjeografike në fletore të punës. Puna e nxënësve duhet të jetë individuale dhe pa tekste.

Mësimitdhënësi viziton nxënësit nëpër banka dhe kontrollon njohuritë e tyre gjatë plotësimit të detyrës, duke kërkuar të interpretojnë hartën.

Bashkangjitur me punën në fletore të punës, në një flet të zbrazët, formon një tabelë me lumenjt e Kosovës sipas ujëmbledhësve.



Ujëmbledhësi i Adriatikut	Ujëmbledhësi i Detit të Zi	Ujëmbledhësi i detit Egje
Drini i Bardhë	Ibri	Lepenci
Ereniku	Morava e Binçës	Nerodimja
Toplluha	Sitnica	
Lumi i Istogut	L. Drenica	
Mirusha...	Lumi i shtrembër...	

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimsdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimsdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 07

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI


Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Kosovës

Rezultati i të nxënësit të temës

-Shpjegon llojet kryesore të tokave në Kosovë dhe shtrirjen e përafërt të tyre.

-Shpjegon tiparet kryesore floristike dhe faunistike të Kosovës dhe elementet dalluese në mes të rajoneve të ndryshme brenda vendit.

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tokat, bota bimore dhe shtazore

Fjalët kyçe: Kosova, klima, faktorët klimatikë, reshjet, temperatura, erërat

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Analizon rolin e faktorëve natyrorë në krijimin e tokave në Kosovë dhe shpjegon rolin e tokës në prodhimtarinë bujqësore.
2. Identifikon veprimtaritë negative në humbjen e tokës dhe masat që duhen ndërmarrë në mbrojtjen e tyre.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimsdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Një të paktën pesë kafshë te egra të hapësirës së Kosovës;
2. Tregon të paktën pesë dobi të tokave për shoqërinë njerëzore;
3. Liston të paktën tre shkaktar të dëmtimit të tokave;
4. Përshkruan në formë grafike shtrirjen vertikale të kateve bimore në Kosovë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlasi, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: (klaster).

Në pjesën hyrëse të orës, mësimmhënësi në qendër të tabelës shkruan “Bota bimore dhe shtazore” dhe kërkon nga nxënësit të shprehin mendimet (informacionin) në formë të degëzimeve që lidhen me klimën në Kosovë. Mësimmhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa- përshtatshme për njësinë “Bota bimore dhe shtazore”.



Vërejtje: Klasteri nuk është plotësuar me arsye që nuk mund të paragjykojmë se çfarë mund të shprehin nxënësit gjatë një ore mësimore.

Pjesa e dytë: Realizohet me teknikën “Ditari dypjesësh”

Në pjesën e dytë të orës, mësimmhënësi ndan tabelën në dy shtylla. Në shtyllën e parë, mësimmhënësi shënon disa fjalë kyçe, të cilat i kishte shënuar më herët në tabelë, dhe kërkon nga nxënësit, që duke lexuar njësinë mësimore “Bota bimore dhe shtazore”, të bëjnë përshkrimin në shtyllën e dytë për këto fjalë:

Citati	Komenti që jepet nga nxënësit
<i>Toka me cilësi të mirë</i>	
<i>Toka me cilësi mesatare</i>	
<i>Toka me cilësi të dobët</i>	
<i>Smonicat</i>	
<i>Tokat aluviale</i>	
<i>2500 lloje bimore</i>	
<i>Pyjet e zonës fushore</i>	
<i>Brezi i pyjeve halore</i>	
<i>Kullotat alpine</i>	
<i>Kafshët e egra në Kosovë</i>	
<i>Humusi</i>	

Pjesa e tretë: Punë individuale dhe pa ndihmën e teksteve.

Në mënyrë individuale, plotëso fletorën e punës te pjesa e botës bimore dhe shtazore.

1. Pse në Kosovë dominojnë tokat me cilësi të dobët?

2. Tokat e kuqe gjenden mbi: a) gëlqerorë b) aluvione c) magmatikë

3. Vrojttoni rrethinën/vendlindjen tuaj dhe tregoni pse po humbet toka bujqësore.

4. Pse Kosova është e pasur me lloje të ndryshme bimore?

5. Mendoni rrethinën/vendlindjen tuaj dhe tregoni për llojet drunore të cilat i njihni.

6. Cilët shpendë jetojnë në rrethinën tuaj?

7. A dini ndonjë shpend shtegtar i cili vjen në vendlindjen tuaj?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimitdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimitdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 08

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Kosovës

Rezultati i të nxëniet të temës

- Analizon shkaqet (faktorët) e popullimit të hershëm të Kosovës
- Argumenton lashtësinë e popullsisë shqiptare dhe të popujve të tjerë në Kosovë
- Arsyeton shkaqet e ndryshimit të numrit të popullsisë shqiptare dhe të popujve të tjerë gjatë periudhave historike
- Analizon dallimet në dendësinë e popullsisë mes regjioneve brenda Kosovës

Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës: _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Popullsia dhe veçoritë e saj - Popullimi i hapësirës së Kosovës

Fjalët kyçe: Popullsi ilire, natalitet, mortalitet, shtim natyror, dendësi e popullsisë.

Rezultati/et e të nxëniet për orë mësimore:

1. Komentojnë ndryshimet e hershme në strukturën e popullsisë së Kosovës dhe arsyetojnë shkaqet e popullimit të hershëm të Kosovës.
2. Dallojnë periudhat për nga shtimi i popullsisë në Kosovë, në grafikon.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Radhitë tri arsye të popullimit të hershëm në hapësirën e Kosovës;
2. Tregon dallimin në mes shtimit natyror dhe atij mekanik;
3. Numëron tetë qyetet me numrin më të madh të popullsisë në Kosovë;
4. Tregon përbërjen etnike të popullsisë së Kosovës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Tabela me fjalë kyçe

Mësimdhënësi paraqet një tabelë grafike dhe në hapësira shënon fjalët kyçe që nxënësit t'i identifikojnë

ato fjalë dhe të plotësojnë me informacione hapësirat e tjera që lidhen (degëzohen) me to.

Ilirët	Sllavët	Turqit	Dardanët	Kosova
Autoktonë				
Paraardhës				
Shqiptarët				
Fiset				

Pjesa e dytë: Punë individuale (pyetje dhe komente).


Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të lexojnë tekstin individualisht dhe në heshtje. Gjatë kohës që nxënësit lexojnë, mësimdhënësi shënon disa pyetje në tabelë.

Pasi të lexohet teksti, nxënësit, në formë vullnetare, plotësojnë me përgjigje tabelën. Mësimdhënësi miraton përgjigjet nëse janë të sakta.

Pyetje	Komente
1. Tregoni nga cili popull banohej Kosova në parahistori dhe antikë.	
2. Cilët popuj erdhën në Kosovë dhe në cilat periudha?	
3. Dalloni fazat e rritjes së popullsisë.	
4. Çka ndikoi në rritjen e ngadalshme të popullsisë në disa periudha kohore?	
5. Cilët komponentë i përfshin lëvizja natyrore e popullsisë?	
6. Tregoni në hartë cilat pjesë të Kosovës janë me dendësi më të madhe?	

Pjesa e tretë: (detyrë individuale)

Analizo grafikun dhe përgjigju në pyetjet e mëposhtme:



Për sa herë është rritur popullsia e Kosovës ndërmjet viteve 1880-1921? _____

Kur është bërë rritja më e madhe e popullsisë në Kosovë (në cilën periudhë). _____

Zgjidh detyrën:

Sipërfaqja e një vendi (shteti) është 123.900km²

Numri i banorëve është: 56.876 banorë

Sa është dendësia mesatare?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimitdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimitdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).


ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**No: 09**

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Kosovës

Rezultati i të nxënës të temës

- Analizon shkaqet (faktorët) e popullimit të hershëm të Kosovës.
- Argumenton lashtësinë e popullsisë shqiptare dhe të popujve të tjerë në Kosovë.

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lëvizja natyrore e popullsisë dhe migrimet e popullsisë së Kosovës

Fjalët kyçe: migrime, shpërngulje, kolonizim, motive të migrimeve, strukturat e popullsisë, struktura moshore, gjinore, etnike, moshë e re.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

1. Arsyeton shkallën e lartë të analfabetizmit në Kosovë dhe tregon arsytet.
2. Analizon përbërjen kombëtare të popullsisë në Kosovë sipas grupeve etnike.
3. Dallon fazat e emigrimit dhe imigrimit të popujve në Kosovë dhe tregon qëllimet e shpërnguljes së shqiptarëve me dhunë në Turqi.
4. Tregon pasojat e kolonizimit në Kosovë dhe përshkruan motivet e migrimeve të brendshme dhe të jashtme.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Radhitë tri arsye të analfabetizmit të lartë në të kaluarën;
2. Tregon të paktën tri arsye të migrimit të jashtëm në Kosovë;
3. Numëron tetë qyetet me numrin më të madh të popullsisë në Kosovë;
4. Tregon në përqindje strukturën e popullsisë sipas moshës;
5. Tregon sipas përqindjes përbërjen etnike të popullsisë në Kosovë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Përsëritje e njësisë së kaluar (diskutim).

Mësimdhënësi fillon orën duke e përsëritur njësinë e kaluar në formën e diskutimit. Për kohën sa është duke u zhvilluar diskutimi, synohet që të ndërlidhet me njësinë e re që do të zhvillohet, pjesën e migrimeve dhe strukturën e popullsisë në Kosovë.

-Kush ishin të parët tanë?

-A janë autokton në hapësirën e Kosovës popullsia sllave?

-Tregoni disa arsye që Kosova kishte shtim të lartë natyror.

Ndërlidhje me pjesën shoqërore:

-Ç'kuptoni me migrim (jepni mendimet tuaja)?

-Cilaj janë disa nga shkaqet që çojnë në lëvizje të popullsisë (migrime)?

...

Kështu, nxënësit njoftohen që do të zhvillohet pjesa shoqërore e Azisë Jugperëndimore, si vazhdim i njësisë së kaluar.

Pjesa e dytë: Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e INSERTIT: (v) - informacion i njohur, (+) - informacion i ri, (-) - informacion që ndryshon nga ai që e di, (?) - sqarime për informacion të paqartë. Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informacione ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetjet e shënuara nga nxënësit, prej mësimdhënësit.

v	+	-	?
(v) Informacion i njohur	(+) Informacion i ri	(-) Informacion që ndryshon nga ai që e di	(?) sqarime për informacionin

Pjesa e tretë: Shkrim i lirë (punë individuale) 15 minuta.

Tema: Popullsia e Kosovës (përmbledhje pa libër, me atlas).

Gjatë shkrimit të lirë, nxënësit shkruajnë pa u ndalur, me qëllim që të shkruarit e tyre të burojnë në

mënyrë të tillë që ata të mos kenë frikë nga kritikata dhe korrigjimet.

Fletat dorëzohen dhe merren në shtëpi nga arsimtari që t'i vlerësojë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimmhdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimmhdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimin, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 10

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Kosovës

Rezultati i të nxënin të temës

- Dallon tipat kryesorë të vendbanimeve në Kosovë.
- Shpjegon kriteret e ndarjes së vendbanimeve dhe funksionet e tyre.
- Argumenton lidhjet mes industrializimit, urbanizimit dhe deagrarizimit.

Rezultatet e të nxënin për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vendbanimet

Fjalët kyçe: vendbanime ilire, romake, orientale, bashkëkohore, fshatra, qytete, urbanizim.

Rezultati/et e të nxënin për orë mësimore:

1. Shpjegon zhvillimin e vendbanimeve sipas periudhave kohore dhe dallon tipet e vendbanimeve sipas madhësisë demografike dhe sipas formës.
2. Arsyeton rritjen e shpejtë demografike të vendbanimeve urbane dhe analizon pasojat e rritjes së

shpejtë të popullsisë urbane.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njëjësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Klasifikon vendbanimet në formë grafike sipas madhësisë demografike;
2. Klasifikon vendbanimet rurale sipas madhësisë demografike, formës dhe funksionit;
3. Numëron të paktën pesë arsye të rritjes së shpejtë të popullsisë urbane;
4. Tregon të paktën katër veçori të vendbanimeve ilire.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Video prezantim/foto kolazh.

Mësimdhënësi prezanton një video (deri në 3') e cila i paraqet "Vendbanimet në Kosovë". Pasi të kryhet video-prezantimi, mësimdhënësi hap diskutimin në formën e "Stuhisë së mendimeve".

- Cilat vendbanime të Kosovës i njihni?
- Sa banorë ka vendbanimi juaj?
- Cilat institucione njihni në qytetin tuaj?

....

Kjo pjesë hyrëse bëhet me arsyen që të kuptohet stadi i njohurive të nxënësve për temën e caktuar (Vendbanimet).




Fjalët kyçe (shembull)

Misisipi	Gadishulli i Labradorit
"anglo-amerika"	Eskimezët
Kodrilieret	Malet Apalache
Gjiri i Meksikës	Indianët

Si reflektim i pjesës së parë, mësimdhënësi shënon fjalët kyçe në tabelë (gjatë rrjedhës së diskutimit) si mendime të "shpejta" që shprehin nxënësit.

Gjithashtu në përfundim të pjesës së parë, mësimdhënësi, së bashku me nxënësit, përpilon deri në tri kritere të suksesit për orën mësimore.



Pjesa e dytë: Klaster

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Vendbanimet në Kosovë) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.

Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të papërshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht ose i angazhon mësimdhënësi.

Vërejtje: Klasteri është paraqitur vetëm si shembull.

Pjesa e tretë: Pyetje, detyra dhe ushtrime (punë në dyshe).

Të plotësohen detyrat në fund të njësisë mësimore pa i përdorur tekstet. Mund të bëhet përjashtim fletorja e klasës. Kjo për arsye që te nxënësit krijon shprehi që t’i marrin shënimet e klasës, sepse iu nevojiten gjatë punës në klasë.

1. Tregoni kur u ndërtuan vendbanimet e para në Kosovë?
2. Cilat ishin veçoritë e vendbanimeve ilire dhe ku ndërtoheshin ato?
3. Çfarë strukture kishin vendbanimet romake dhe ku ndërtoheshin ato?
4. Tregoni çka e dallon fshatin nga qyteti.
5. Dalloni vendbanimet sipas madhësisë demografike në Kosovë.
6. Kategorizoni vendbanimet sipas funksionit dhe formës në Kosovë.
7. Komentoni dendësinë e vendbanimeve.
8. Analizoni nivelin e urbanizimit dhe veçoritë e qyteteve të Kosovës.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

Testoni njohuritë

Punë individuale dhe pa ndihmën e teksteve.

Mësimdhënësi i sjell të gatshme fletët e punës për aktivitetin. Nxënësit gjatë punës mund të përdorin vetëm atlasët. Pas kohës prej 30 minutash, mësimdhënësi i vlerëson dhe i tregon notat para tyre.

1	<p>Në fotografi janë paraqitur me ngjyra dhe numra tri rrjedha të lumenjëve.</p> <p>Përshkruaje rrjedhën e saktë të lumit Danub, nëpër cilat vende të Ballkanit kalon dhe në cilin det derdhet?</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p>	
---	--	--

2	Lidh me shigjetë majat malore me malet:
---	---

Gjeravica 2656m	•	Malet e Sharrit
Panqiqi 2017m	•	Bjeshkët e Nemuna
Luboteni 2496m	•	Malet Qendrore
Goleshi 1019m	•	Kopaoniku

E vërtetë/E gabuar (V/G)

3	• Malet përbëjnë rreth 63% të territorit të Kosovës	V	G
	• Mali i Bardhë është maja më e lartë në Kosovë me 4810m	V	G
	• Maja e Pashtrikut është e lartë 1988m	V	G
	• Fusha e Dukagjinit është e gjatë 70 km dhe 43 km e gjerë	V	G

4	Kosova ishte e populluar herët që në parahistori. Identifiko (nënvizo) pesë faktorët kryesor që ndikuan në popullimin e Kosovës:
---	--

Bregoret e kodrinat; Klima tropikale; Bregdeti; Kullotat; Ujrat e rrjedhshëm dhe nëntokësor; Prania e ishujve të shumtë; Gejzeret; Klima e shëndoshë; Pyjet; prania e savaneve.

5	Cilët janë faktorët që ndikuan në migrimet e popullsisë së Kosovës ndër vite?
---	---

Mësimdhënësi shton ose ndryshon pyetjet sipas nevojës së çfarë (teme-njësie) dëshiron të vlerësojë

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 12

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Kosovës

Rezultati i të nxënit të temës

- Dallon faktorët natyrorë dhe shoqërorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës.
- Vlerëson rolin e kushteve historike, politike dhe shoqërore në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veçoritë ekonomike të Kosovës dhe faktorët e zhvillimit ekonomik

Fjalët kyçe: Ekonomia, etapat e zhvillimit, reforma agrare, komasacioni, ndërmarrjet e vogla

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Shpjegon gjendjen ekonomike të Kosovës para Luftës II Botërore, pas saj dhe në kohën e sotme.
2. Analizon gjendjen e ekonomisë së Kosovës pas vitit 1999 dhe nxjerrin përfundime duke identifikuar pikat e forta.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Numëron pesë faktorët kryesor natyrorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik;
2. Numëron tre faktorët kryesor shoqëror që ndikojnë në zhvillimin ekonomik;
3. Dallon të paktën pesë minerale jometalike ndër mineralet tjera në Kosovë;
4. Numëron të paktën pesë minerale metalike që është e pasur Kosova;
5. Liston tri resurset kryesore energjetike të Kosovës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Përsëritje e njësisë së kaluar (diskutim).

Mësimdhënësi fillon orën duke e përsëritur njësinë e kaluar në formën e diskutimit. Për kohën sa është duke u zhvilluar diskutimi, synohet që të ndërlihet me njësinë e re që do të zhvillohet, me pjesën “faktorët e zhvillimit ekonomik”.

- Çka paraqet një vendbanim?
- Si i kemi ndarë vendbanimet për nga funksioni dhe nga madhësia?
- Sa vendbanime ka në Kosovë?
- Cilat janë përparësitë e fshatit ndaj qyteti?

Ndërlidhje me pjesën shoqërore:

- Çka është ekonomia?
- Çfarë dini për ekonominë e Kosovës në të kaluarën dhe tani?
- Përshkruani ekonominë e vendit tuaj (lokal)?

Kështu nxënësit njoftohen që do të zhvillohet pjesa ekonomike për Republikën e Kosovës.

Pjesa e dytë: Pyetje dhe komente (pune individuale).

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të lexojnë tekstin individualisht dhe në heshtje.

Duke marrë parasysh që janë dy njësi mësimore, mësimdhënësi ndan në 2 paragrafe tekstin dhe drejton nxënësit të lexojnë vetëm pjesën e tyre. “VEÇORITË EKONOMIKE TË KOSOVËS”, ndahet në dy pjesë; “FAKTORËT E ZHVILLIMIT EKONOMIK”, ndahet në tri pjesë.

Gjatë kohës që nxënësit lexojnë, mësimdhënësi shënon disa pyetje në tabelë (i sjell të gatshme).

Pasi të lexohet teksti, nxënësit në formë vullnetare plotësojnë me përgjigje tabelën. Mësimdhënësi miraton përgjigjet nëse janë të sakta.

Të gjithë nxënësit përshkruajnë në fletoret e klasës informacionet që janë paraqitur në tabelë në formën e pyetjeve dhe komenteve nga nga të gjithë paragrafët e të dy njësive mësimore. Kështu mësimdhënësi përmbledh të dy njësitë.

Pyetje	Komente
1. Tregoni si ndikuan luftërat e fillimshkullit XX në zhvillimin ekonomik të Kosovës?	
2. Çka është reforma agrare dhe cilat ishin qëllimet e saj?	
3. Cilat ishin fazat e zhvillimit ekonomik të Kosovës pas Luftës II Botërore?	
4. Shpjegoni si u shkatërrua ekonomia e Kosovës gjatë viteve të 90-ta.	
5. Komentoni veçoritë e ekonomisë së Kosovës pas vitit 1999.	
6. Pse Kosova një kohë të gjatë ka qenë e prapambetur ekonomikisht?	
7. Përmendi faktorët natyrorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik.	
8. Cilat janë resurset kryesore energjetike të vendit?	
9. Cilat janë veçoritë kryesore të popullsisë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik?	

Pjesa e tretë: Mësimdhënësi parashtron një çështje para klasës, ku u kërkon nxënësve që të argumentojnë pse janë *pro* ose *kundër* çështjes, duke i shënuar në organizuesin grafik. Mendimet do të

shkëmbehen në dyshe e në katërshe. Klasa do të pozicionohet në dy grupe, ku nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre.

Bëhet një raportim para klasës për arsyet që janë zgjedhur *pro* ose *kundër* çështjes. Për çdo paraqitje caktohet një kufi kohor prej një minute. Gjatë kohës që dy grupet raportojnë arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion dhe të shkojnë në grupin që ka arsyet më bindëse.

Diskutoni pse PO dhe pse JO (pranohen arsyeime të shkurta). Në fund tregoni rezultatin sa kanë shprehur mendimin që PO dhe sa që JO.

Në formën e diskutimit mund të bëhet dallimi në mes të kaluarës dhe të tashmën së gjendjes ekonomike të Kosovës. Për fund i pyet: A ka ndryshuar dikush mendim?

A mendoni
që Republika
e Kosovës ka
mjaftueshëm
resurse
natyrore dhe
humane që
të ndikojë në
zhvillimin
ekonomik?

PO

JO

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimitdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimitdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 13

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Kosovës

Rezultati i të nxënimit të temës

- Vlerëson rolin e klimës në ekonomi e në shoqëri.
- Vlerëson rolin e ujërave në zhvillimin ekonomik.
- Shpjegon rëndësinë e ekonomisë bujqësore në ekonominë dhe zhvillimin e vendit.
- Argumenton përshtatshmërinë e mjedisit gjeografik për zhvillimin e ekonomisë bujqësore.
- Analizon kushtet natyrore që ka Kosova për zhvillimin e bujqësisë.

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Faktorët shoqërorë në zhvillimin e bujqësisë

Fjalët kyçe: Bujqësia, kulturat bujqësore, kooperativat, rendimentet.

Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore:

1. Analizon rolin e faktorëve shoqërorë në zhvillimin e bujqësisë dhe identifikon strukturën e sipërfaqeve të punueshme të tokave.
2. Përshkruan veçoritë dhe sfidat e sotme për zhvillimin e blegtorisë në Rep. e Kosovës.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Numëron tre faktorët kryesor shoqëror në zhvillimin e bujqësisë;
2. Citon tri përparësi të shoqërisë kosovare për zhvillimin e bujqësisë;
3. Numëron pesë sfidat kryesore të ditëve të sotme në zhvillimin e bujqësisë;
4. Liston tri llojet më produktive të tokave në Kosovë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Xhiksou/Grupet e ekspertëve (nxënësit ndahen në grupe).

Mësimdhënësi ndan nxënësit në tri grupe (grupe familjare), ku secili nxënës ka një numër 1, 2, 3. Pasi nxënësit të jenë përcaktuar sipas numrave, bashkohen njëshat bashkë (1), dyshat bashkë (2) dhe treshat bashkë (3) që njihen si “grupet e ekspertëve”.

Mësimdhënësi i jep secilit grup nga një detyrë (fleta me pyetje dhe detyra) që janë pjesë e tekstit që do e shtjellojnë. Nxënësit lexojnë pjesën e caktuar për kohë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të

çështjes për të cilën janë caktuar. Pas “ekspertizës”, nxënësit kthehen në grupet amë (familjare) dhe për një kohë të shkurtër i shpjegojnë njëri-tjetrit njohuritë e tyre për njësinë. Pjesët me ngjyra në libër: “faktet” dhe “Gjeografia për kureshtarë” dhe “bota bimore dhe shtazore” i lexojnë të gjitha grupet. Aktiviteti ndahet sipas kohës: Pjesa e parë 5 minuta, pjesa e dytë 25 minuta dhe pjesa e tretë 15 minuta.

Kjo teknikë mund të përdoret në tri etapat e orës. Nëse modifikohet mund të përdoret vetëm në pjesën shtjelluese të orës.

Pjesa e dytë: (punë në grupe)

Grupi 1

- Cila ishte gjendja e bujqësisë para luftës në Kosovë?
- Çka paraqet bujqësia ekstensive?
- Kur filloi modernizimi i bujqësisë në Kosovë?
- Çka paraqiste kooperativa bujqësore?

Grupi 2

- Cilat janë kulturat kryesore bujqësore në Kosovë?
- Cili është dallimi i rendimentit të drithërave ndërmjet viteve të 80-ta dhe sot?
- Cilat ishin perimet më të mbjella në Kosovë?
- Tregoni disa bimë industriale që kultivoheshin dikur dhe sot në hapësirën e Kosovës..

Grupi 3

- Cilat ishin zonat me të njohura me vreshta?
- Përshkruani pylltarinë në Kosovë gjatë kohëve.
- Cilat janë llojet e pyjeve që rriten në Kosovë?
- Përshkruani në pika të shkurta blegtorinë në Kosovë?

-Grupet në fund të pjesës së dytë dorëzojnë detyrën në grup te mësimit.

Pjesa e tretë: (reflektim në grupe)

Të lexohen punimet/detyrat e grupeve, gjithnjë duke i përcjellë me hartë nëse kërkohet.

Nxënësit e tjerë pasi dëgjojnë prezantimin, mund të drejtohen me pyetje për informacion shtesë nëpërmjet udhëheqësit të grupit. Gjithashtu edhe mësimit për të kuptuar më shumë mund t’ju drejtohet me pyetje, gjithnjë duke pasur parasysh kohën që kemi në dispozicion.

Mësimit i vlerëson nxënësit si grup dhe si punë individuale, gjithnjë duke i respektuar kriteret e parashtruara. Mbani shënime në listën e kontrollit ose ndonjë instrument specifik më të përshtatshëm për punën tuaj gjatë vlerësimit të vazhdueshëm.

Detyrë shtëpie: Plotëso në fletore të punës: **Faktorët shoqërorë në zhvillimin e bujqësisë**


VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimit kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimit kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Në pjesën hyrëse të orës, mësimitdhënësi në qendër të tabelës shkruan “Bota bimore dhe shtazore” dhe kërkon nga nxënësit të shprehin mendimet (informacionin) në formë të degëzimeve që lidhen me klimën në Kosovë. Mësimitdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të papërshtatshme për njësinë “Klima e Kosovës”.



Vërejtje: Klasteri nuk është plotësuar me arsyen që nuk mund të paragjykojmë se çfarë mund të shprehin nxënësit gjatë një

ore mësimore.

Pjesa e dytë: Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e INSERTIT: (√) - informacion i njohur, (+) - informacion i ri, (-) - informacion që ndryshon nga ai që e di, (?) - sqarime për informacion të paqartë. Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informacione ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetjet e shënuara nga nxënësit, prej mësimitdhënësit.

√	+	-	?
(√)- Informacion i njohur	(+)- Informacion i ri	(-) Informacion që ndryshon nga ai që e di	(?)-sqarime për informacionin

Pjesa e tretë: Kontrollim i njohurive (punë individuale dhe pa tekste)

Pyetje, detyra dhe ushtrime:

1. Dalloni fazat e zhvillimit të industrisë në Kosovë.
2. Cilat degë të industrisë u zhvilluan të parat?
3. Tregoni cilat janë lidhjet në mes të zhvillimit të energjetikës dhe pasurive natyrore.
4. Tregoni në cilat rezerva natyrore bazohet industria me ngjyra.
5. Pse industria e drurit u zhvillua në pjesët periferike të Kosovës?

Detyra: Shëno në hartën memece përhapjen e industrisë sipas qendrave në Kosovë.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimsdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimsdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 15

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4

Klasa: IX

Tema: Veçoritë ekonomiko-shoqërore të Kosovës

Rezultati i të nxënit të temës

- Krahason rrjetin rrugor dikur dhe tani, si dhe perspektivën për të ardhmen në zhvillimin e transportit.
- Analizon anët pozitive dhe negative të transportit automobilistik, hekurudhor dhe ajror, si dhe zhvillimin e tyre.
- Shpjegon kushtet kryesore natyrore, kulturore dhe shoqërore që ndikojnë në zhvillimin e turizmit në Kosovë.
- Identifikon zonat kryesore turistike, potencialin turistik që ka Kosova dhe shpjegon rolin e turizmit në ekonomi.
- Vlerëson rolin e turizmit, tregtisë, transportit, shërbimeve dhe të artizanateve në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Komunikacioni, tregtia, zejtaria dhe turizmi

Fjalët kyçe: Kosova, komunikacioni, eksporti, importi, zejet, turizmi.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Shpjegon shtrirjen e rrjetit rrugor dhe hekurudhor në hapësirën e Kosovës.
2. Interpretin rolin e importit dhe eksportit dhe tregton rëndësinë e tyre në zhvillimin e turizmit.
3. Tregton zejet kryesore sipas kohës dhe tregton qendrat ku zhvillohen këto veprimtari në Kosovë.
4. Interpretin objektet e ofertës natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit në Kosovë.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Numëron pesë faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin e turizmit;
2. Skicon një tabelë të katëgorizuar sipas llojit të zejeve (të reja dhe të vjetra);
3. Vlerëson tre llojet kryesore të transportit sipas zhvillimit të tyre në Kosovë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Xhiksou/Grupet e ekspertëve (nxënësit ndahen në grupe).

Mësimdhënësi ndan nxënësit në tri grupe (grupe familjare), ku secili nxënës ka një numër 1, 2, 3. Pasi nxënësit të jenë përcaktuar sipas numrave, bashkohen njëshat bashkë (1), dyshat bashkë (2) dhe treshat bashkë (3) që njihen si “grupet e ekspertëve”.

Mësimdhënësi i jep secilit grup nga një detyrë (fleta me pyetje dhe detyra) që janë pjesë e tekstit që do e shtjellojnë. Nxënësit lexojnë pjesën e caktuar për kohë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar. Pas “ekspertizës”, nxënësit kthehen në grupet amë (familjare) dhe për një kohë të shkurtër i shpjegojnë njëri-tjetrit njohuritë e tyre për njësinë. Pjesët me ngjyra në libër: “faktet” dhe “Gjeografia për kureshtarë” dhe “bota bimore dhe shtazore” i lexojnë të gjitha grupet.

Aktiviteti ndahet sipas kohës: Pjesa e parë 5 minuta, pjesa e dytë 25 minuta dhe pjesa e tretë 15 minuta.

Kjo teknikë mund të përdoret në tri etapat e orës. Nëse modifikohet mund të përdoret vetëm në pjesën shtjelluese të orës.

Pjesa e dytë: (punë në grupe)

Grupi 1 (Komunikacioni)

- Rrugët në Kosovë kategorizohen në disa kategori. Cilat janë ato?
- Cilat janë autoudhët më të njohura në Rep. e Kosovës?
- Sa kilometra hekurudhë ka në Kosovë?

Detyra: Krijë një tabelë me tri llojet e transportit më të zhvilluar në Kosovë dhe vlerëso me fjalët tuaja (duke argumentuar) llojin sipas rëndësisë.

Grupi 2 (Tregtia)

- Çka paraqet TREGTIA?
- Me cilat prodhime ishte e njohur Kosova?
- Cili ishte bilanci tregtar sipas të dhënave të vitit 2019?
- Përshkruani në tri pika eksportin në Kosovë.

Grupi 3 (Zejtaria)

- Çka është ZEJTARIA?
- Tregoni disa nga qendrat më të mëdha zejtare në Kosovë.
- Si ndaheshin zejet sipas grupeve të popullsisë?
- Detyrë: Skico tabelën në dy kategori të zejeve (të reja dhe të vjetra).

Grupi 3 (Turizmi)

- Çka paraqet TURIZMI?
- Cilat janë qendrat më të njohura turistike në Kosovë?
- Cilat janë parakushtet për zhvillimin e turizmit?
- Cilat forma të turizmit mund të zhvillohen në Kosovë?
- Cilat janë motivet kryesore kulturoro-historike për zhvillimin e turizmit në Kosovë?

-Grupet në fund të pjesës së dytë dorëzojnë detyrën në grup te mësimdhënësi.

Pjesa e tretë: (reflektim në grupe)

Të lexohen punimet/detyrat e grupeve, gjithnjë duke i përcjellë me hartë nëse kërkohet.

Nxënësit e tjerë pasi dëgjojnë prezantimin, mund të drejtohen me pyetje për informacion shtesë nëpërmjet udhëheqësit të grupit. Gjithashtu edhe mësimdhënësi për të kuptuar më shumë mund t'ju drejtohet me pyetje, gjithnjë duke pasur parasysh kohën që kemi në dispozicion.

Mësimdhënësi i vlerëson nxënësit si grup dhe si punë individuale, gjithnjë duke i respektuar kriteret e parashtruara. Mbani shënime në listën e kontrollit ose ndonjë instrument specifik më të përshtatshëm për punën tuaj gjatë vlerësimit të vazhdueshëm.


Detyrë shtëpie: Plotëso në fletore të punës: Transporti, tregtia, zejtaria dhe turizmi.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupe. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

Testimi i parë

RREGULLAT GJATË TESTIMIT		No. 16	
•Mos komunikoj me shoqen apo shokun; •Kujdes në rrumbullaksim e alternativave; •Vetëm një alternativë është e saktë; •Shëno shkrimin e lexueshëm; Mos e dëmto testin; •Respektoje kohën.			
Tema: 1: Ballkani (20%) 2: Kosova (80%)		--Shembull--	
<i>Klasa – IX</i>	Emri dhe Mbiemri: _____	Pikët	
1	Lumi më i gjatë në G. Ballkanik është: a) Lumi Po b) Vollga c) Sena d) Danubi	8	
2	Bashko me vija lumenjtë me detin përkatës: a. Nerodima Adriatik b. Sitnica Egje c. Toplluha Deti i Zi	8	
3	Sipas origjinës, si ndahen liqenet në Kosovë: _____ _____	9	
4	Nëse ndodheni në Prishtinë, atëherë qyteti i Pejës për ju është: a) në veri b) në perëndim c) në lindje	9	
5	Cila nga alternativat e paraqet të saktë kuptimin për bifurkacionin: a) Bifurkacioni paraqet ndarjen e qytetit në dy pjesë nga lumi ; b) Bifurkacioni paraqet ndarjen e liqenit në dy pjesë.; c) Bifurkacioni paraqet ndarjen e lumit në dy lumenj, përkatësisht në dy pellgje.	9	
6	Përshkruani rrjedhën e lumit Danub gjatë tërë territorit ballkanik. _____ _____ _____	10	
7	Analizo grafikun dhe sipas numrave shkruaj lumenjtë që kërkohen në hartë: 1 _____ 2 _____ 3 _____ 4 _____ 5 _____		11

8	Rendit elementet përkatëse të regjioni përkatës.	Regjioni Perëndimor	Prishtina Drenica Prizreni Lumi Drin Anamorava	Gjakova Sitnica Mitrovica Dushkaja Pashtriku	Regjioni Lindor	11
9	“Bjeshkët e Nemuna”	2656m	Jugperëndim	Ereniku		12
10	Vlerësoni rolin e resurseve natyrore për zhvillimin ekonomik të Kosovës. _____ _____ _____					13
Përqindja	0 - 39 %	40% - 59 %	60% - 79%	80% - 89%	90% - 100%	Pikët: () ()
Pikët	0 -39 pikë	40 - 59 pikë	60 - 79 pikë	80 - 89 pikë	90 – 100 pikë	
Nota	1	2	3	4	5	
Shenjat korigjuese: √- e saktë, x- e pasaktë, ~- e paplotësuar				Mësimdhënësi: _____		

Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve - Klasa IX

Fusha/Tema mësimore		Njohja	Të kuptuarit	Zbatimi	Mendimi kritik	Shuma
		20%	30%	10%	40%	100%
Gadishulli Ballkanik	20%	2 (16p)	1 (9p)	1 (10p)	Analizë - 1 (11p) Analizë - 1 (11p)	3 (57p)
Veçoritë natyrore dhe shoqërore të Kosovës	80%		2 (18 p)		Sintezë - 1 (12p) Vlerësim - 1 (13p)	4 (43p)
Totali i pikëve	100%	16 pikë	27 pikë	10 pikë	47 pikë	100 pikë

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 17

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Prezantim i punimeve: Republika e Kosovës

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Prezantim i punimeve në dyshe, në PoëerPoint.

Punimi duhet t'u përmbahet kriterëve që mësimdhënësi i ka paraqitur me detyrën, disa orë (dy javë) më herët.

Vlerësimi i punës

Për të nxjerrë notën veprimtare kështu (shembull):

$$3 \times 0.20 + 5 \times 0.20 + 4 \times 0.10 + 5 \times 0.30 + 3 \times 0.20 = 0.60 + 1 + 0.40 + 1.5 + 0.60 = 4,1 \text{ pra nota është } 4$$

Emri i nxënësit	Ilustrimet 20%	Burimet 20%	Artikulimi 10%	Shpjegim 30%	Bashkëpunimi 20%	Nota
1	3	5	4	5	3	4
2						
3						
4						

Mësimdhënësi mund të formojë një instrument sipas kriterëve të veta ose t'i paraqesë kriteret së bashku me nxënësit.

Instrumenti 3 - Prezantim me gojë (30%). Nxënësi vlerësohet sipas standardeve të vlerësimit, të përshkruara në: UA, Kurrikulën bërthamë dhe Udhëzuesin për vlerësim.

Nota 5. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin dhe ofron fakte, argumente dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve. Ofron faktet gjeografike, njeh objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëri-

të dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik.

Nota 4. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin, ofron fakte dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve, jo në formë shumë të saktë. Ofron faktet gjeografike, njeh objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik jo shumë të saktë.

Nota 3. Nxënësi i përgjigjet pyetjeve të arsimtarit, por jo mjaftueshëm. Ka shprehje të rrjedhshme dhe deri diku të logjikshme, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell më me ngecje nga mungesa e leximit të mjaftueshëm. Ofron faktet gjeografike, njeh disa objekte gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike (ato që i di) si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; Paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehitë, të dinë të shërbehen me to.

Nota 2. Nxënësi mundohet të bisedojë, ofron fakte gjatë bisedës, por shumë pak. Vërehet mungesa e leximit, nuk i plotëson as 30% të kriterëve të lartpërmendura.

Nota 1. Nxënësi nuk u përgjigjet pyetjeve, nuk bashkëbisedon. Nuk i plotëson kriteret e lartpërmendura as 20%.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 18

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Regjionet gjeografike të Kosovës

Rezultati i të nxënit të temës

• *Dallon regjionet kryesore të Kosovës (regj. Lindor dhe Perëndimor) duke i diferencuar në bazë të veçorive natyrore dhe humane të tyre.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. *Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.*

3.1. *Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.*

3.2. *Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.*

RNF: 4. *Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.*

4.1. *Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.*

4.2. *Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Regjionet gjeografike: Regjioni Lindor i Kosovës

Fjalët kyçe: Regjioni Lindor, Rrafshi i Kosovës, linjiti, Prishtina.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Përkufizon shtrirjen gjeografike të Regjionit Lindor të Kosovës dhe diferencon tërësitë kryesore natyrore përbrenda këtij regjioni.
2. Identifikon resurset energjetike dhe minerale sipas rajoneve të caktuara gjeografike.
3. Përshkruan karakteristikat kryesore populative dhe ekonomike, sipas rajoneve të caktuara gjeografike.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Identifikon në hartë tërësitë kryesore të Regjionit Lindor;
2. Tregon të paktën tri karakteristika për secilen tërësi të Regjionit Lindor;
3. Identifikon me hartë qendrat kryesore të njësive gjeografike.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Vendose në vendin e duhur (punë individuale).

Mësimdhënësi në tabelë paraqet disa fjalë (emra qytetesh), rajone gjeografike, toponime... ku kërkon nga nxënësit që t'i vendosin sipas regjioneve gjeografike përkatëse. Aktiviteti do të realizohet më mirë sikur tabela të jetë magnetike dhe fjalët kyqër të ngjiten.

Pjesa hyrëse realizohet si lojë që mundëson nxënësve të relaksohen dhe të motivohen për vazhdimin e mësimin.

Regjioni Lindor

Regjioni Perëndimor

Gjakova, Prishtina, Besiana, Anamorava, Gjeravica, Qyqavica, Prizreni, Mitrovica, klima kontinentale, klima e mesme kontinentale, Dushkaja...

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Regjioni Lindor i Kosovës) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.


Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht osë aktivizohen nga mësimdhënësi.

Vërejtje: Klasteri është paraqitur vetëm si shembull.

Pjesa e tretë: Shkrim i lirë (15')

Tema: Regjioni Lindor i Kosovës (përmbledhje pa libër, me atlas).



Gjatë shkrimit të lirë, nxënësit shkruajnë pa u ndalur, me qëllim që të shkruarit e tyre të burojë në mënyrë të tillë që ata të mos kenë frikë nga kritikata dhe korrigjimet.

Fletat dorëzohen dhe merren në shtëpi nga arsimtari që t'i vlerësojë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësuesi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


No: 19

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Regjionet gjeografike të Kosovës

Rezultati i të nxënës të temës

•Dallon regjionet kryesore të Kosovës (regj. Lindor dhe Perëndimor) duke i diferencuar në bazë të veçorive natyrore dhe humane të tyre.

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Regjionet gjeografike: Regjioni Perëndimor i Kosovës

Fjalët kyçe: Regjioni Perëndimor, Dukagjini, Bjeshkët e Nemuna, Sharri

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

1. Përkufizon shtrirjen gjeografike të Regjionit Perëndimor të Kosovës dhe diferencon tërësitë kryesore natyrore përbrenda këtij regjioni.
2. Identifikon resurset energjetike dhe minerale sipas rajoneve të caktuara gjeografike të regjionit.
3. Përshkruan karakteristikat kryesore populative dhe ekonomike, sipas rajoneve të caktuara gjeografike.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Identifikon në hartë krahinat malore dhe kodrinore-malore të Regjionit Perëndimor;
2. Tregon të paktën pesë karakteristika për Rrafshin e Dukagjinit;
3. Identifikon me hartë qendrat kryesore të njësive gjeografike;
4. Tregon nga tri karakteristika kryesore populative të rajoneve në Regjionin Perëndimor.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Mësimdhënësi fillon orën duke e përsëritur njësinë e kaluar në formën e diskutimit. Për kohën sa është duke u zhvilluar diskutimi, synohet që të ndërlihet me njësinë e re që do të zhvillohet, pjesën "Regjioni Lindor i Kosovës".

-Tregoni njësitë gjeografike të Regjionit Lindor?

- Cilat janë qendrat e këtij regjioni?
- Sa janë dimensionet e Fushës së Kosovës?
- Tregoni me hartë se ku gjendet Drenica?

Ndërlidhje me pjesën shoqërore:

- Cilat janë qytetet që ndodhen në regjionin Perëndimor?
- Çfarë dini për pjesën perëndimore të Kosovës?
- Përshkruani me pak fjalë vendin ku ju jetoni?

Kështu nxënësit njoftohen që do të zhvillohet pjesa ekonomike për Republikën e Kosovës.

Pjesa e dytë: Klaster

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Regjioni Perëndimor i Kosovës) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.

Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të papërshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht osë aktivizohen nga mësimdhënësi.



Vërejtje: Klasteri është paraqitur vetëm si shembull.

Pjesa e tretë: Shkrim i lirë (15')

Tema: Regjioni Perëndimor i Kosovës (përmbledhje pa libër, me atlas)

Gjatë shkrimit të lirë, nxënësit shkruajnë pa u ndalur, me qëllim që të shkruarit e tyre të burojnë në mënyrë të tillë që ata të mos kenë frikë nga kritikata dhe korrigjimet

Fletat dorëzohen dhe merren në shtëpi nga arsimtari që t'i vlerësojë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësuesi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 20

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4

Klasa: IX

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Testoni njohuritë: Regjionet gjeografike të Kosovës

Mësuesi sjell të gatshme fletët e punës për aktivitetin. Nxënësit gjatë punës mund të përdorin vetëm atlasët. Puna individuale dhe pa ndihmën e teksteve, vetëm me ndihmën e hartës.

1	Fushëgropa e Kosovës është e gjatë ____ km dhe me gjerësi mesatare ____ km. Ajo shtrihet nga Mitrovica në veri e deri te _____ në jug me sipërfaqe 1300km ²
2	Kosova ka potencial të mirë për zhvillimin e turizmit. Cilat lloje të turizmit mund të zhvillohen në Kosovë? _____ ; _____ ; _____ ; _____ .

4. Është trevë malore në jug të Opojës, shtrihet deri në kufi me Maqedoninë. Është e banuar me popullsi gorane të fesë myslimane dhe gjuhë të përzier (sllave). Qendër e kësaj treve është Dragashi, me rreth 2000 banorë?

Për cilën trevë bëhet fjalë?

A. Gora



B. Hasi

3

Në hartë janë dhënë disa numra që tregojnë njësitë gjeografike të Regjionit Lindor të Kosovës. Identifikoni njësitë sipas numrit:

A 1 _____ 2 _____
3 _____ 4 _____
5 _____ 6 _____
7 _____

B 1 _____ 2 _____
3 _____ 4 _____
5 _____ 6 _____
7 _____



C. Rugova

D. Sreçka

5. Është trevë e vogël në pjesën verilindore të regjionit lindor. Kryeqendra e kësaj treve është Besiana me rreth 30 mijë banorë. Për cilën trevë bëhet fjalë?

A. Anamorava

B. Siriniqi

C. Llapi

D. Llapusha

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 21

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi


Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Regjionet gjeografike të Kosovës

Rezultati i të nxënit të temës

• *Analizon ecurinë dhe sfidat e Kosovës, drejt anëtarësimit në BE.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Republika e Kosovës, veçoritë juridike, politike, administrative dhe gjeografike dhe sfidat drejt BE-së.

Fjalët kyçe: Shteti, institucionet, territori, kuvendi

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

1. Analizon elementet themelore politiko-gjeografike të shtetit të Kosovës.
2. Tregon në formë kronologjike për rrugëtimin e statusit politik të Kosovës deri te pavarësia.
3. Përshkruan me fjalë institucionet kryesore demokratike të Rrepublicës së Kosovës.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Identifikon në hartën memece komunat e Kosovës;
2. Tregon të paktën tri karakteristika të funksionit për secilin institucion;
3. Përshkruan me hartë kufijt administrativ të Kosovës;
4. Skicon në formë kronologjike datat e rëndësishme politike të Kosovës.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Mësimdhënësi fillon orën me një galeri (disa fotografi) që paraqesin institucionet shtetërore. Ketu duhet bashkëngjitur edhe fotografi të Kryeministrit, Presidentit... por për arsye që individët mund të zëvendësohen, nuk janë paraqitur fotografi individësh.

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të shprehin atë që dinë për fotografitë dhe në formën e fjalëve kyçe i shënon disa në tabelë, që të përdoren si referenca gjatë zhvillimit të mësimi.

-Kush është President i Kosovës?

-Kush është Kryeministër?

-Çka paraqet Kushtetuta?

...



Pjesa e dytë: Në pjesën e dytë, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit (njëri nga ata) ose lexon vetë me zë pjesën e njësive (paragrafin). Kur përfundon leximi, diskutohet për atë se çka u lexua, gjithnjë duke shpjeguar me hartë.

- Pas këtij leximi, nxënësvë u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përmbajtjes:

- Cilat janë trojet që iu shkëputën trungut shqiptar gjatë kohëve?

-Në cilin vit Kosova shpalli pavarësinë?

- Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës/paragrafit 2, 3...

-Cilat janë pakicat që përbëjnë popullsinë e Kosovës?

-Cilat janë Institucionet themelore demokratike?

-Si është i strukturuar Parlamenti i Kosovës?

-Çka paraqet Kushtetuta e Kosovës?

-Kur hyri në fuqi Kushtetuta e Kosovës?

-Si zgjidhet Presidenti i Kosovës?

-Si formohet Qeveria e Kosovës?

-Sa komuna ka sot Kosova pas decentralizimit?

- Çfarë statusi territorialo-administrativ kishte Kosova në kuadër të Perandorisë Osmane?


- Pas leximit të fundit, nxënësve mësimdhënësi duhet t'u japë mundësi që ata të flasin me njëri-tjetrin e jo përmes tij. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës. Në fund, mësimdhënësi pyet nxënësit. A ka Kosova potencial hidroenergjetik?

Pjesa e tretë: Në pjesën e tretë, puna me fletore të punës.

- Në fletoren e punës, plotësoni hartën memece me emrat e komunave.

- Skiconi një tabelë duke paraqitur kronologjikisht datat historike për Kosovën.

Puna vazhdohet në dyshe, së bashku me ndihmën e mësimdhënësit.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimsdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimsdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 22

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Shqipërisë

Rezultati i të nxënësit të temës

• Shpjegon veçoritë e përgjithshme natyrore të Shqipërisë.

Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shqipëria - pozita gjeografike

Fjalët kyçe: Shqipëria, deti Adriatik dhe Jon, pozita gjeografike, lidhjet komunikative.

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Interpreton pozitën gjeografike të Shqipërisë dhe tregon rëndësinë e daljes në det të Shqipërisë.
2. Analizon rëndësinë e pozitës gjeografike në raport me korridorët kryesorë, tokësorë e detarë.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpiqen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimsdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtepi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Identifikon në hartën shtetet me të cilat kufizohet Shqipëria;
2. Tregon pozitën gjeografike të Shqipërisë në hartë;
3. Identifikon format bregdetare kryesore të Shqipërisë;
4. Tregon me hartë tri arteriet kryesore rrugore të Shqipërisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

Pjesa e parë: “Asociacion” me në qendër Shqipëria

Arsimtari formon një asociacion në tabelë, si vegëz, që nxënësit të gjejnë njësinë që do të zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë.

“**Porta e Adriatikut**” – pozicioni i Shqipërisë në hyrje të detit Adriatik.

“**Kuq e zi**”- ngjyrat simbolike të shqiptarëve (flamurit).

Buna - lumi i vetëm i lundrueshëm në Shqipëri.

Ultësira Perëndimore - hapësirë territoriale që karakterizohet me ultësirë (deri në 200m lartësi) në perëndim të Shqipërisë (ndahet në disa fusha më të vogla: e Shkodrës, e Lezhë-Tiranës, e Myzeqesë, e Durrësit, e Elbasanit).

Nxënësit mund edhe të mos kenë njohuri për elementet e asociacionit, por mësimsdhënësi u jep ndihmën që ata t’i gjejnë dhe t’i mësojnë njëkohësisht gjatë diskutimit dhe punës.

A	B	C	D
“ Porta e Adriatikut ”	“kuq e zi”	Buna	Ultësira Perëndimore


SHQIPËRIA

Pjesa e dytë: Klaster (punë individuale).

Mësimsdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Regjioni Perëndimor i Kosovës) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.

Mësimsdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.

Nxënësit aktivizohen vullnetarisht osë aktivizohen nga mësimsdhënësi.



Vërejtje: Klasteri është paraqitur vetëm si shembull.

Pjesa e tretë: Plotëso fletoren e punës

Në mënyrë individuale plotëso fletoren e punës, duke mos e përdorur tekstin bazë. Vetëm me hartë ose atlas.

Plotëso: SHQIPËRIA – POZITA GJEOGRAFIKE

1. Shqipëria shtrihet në?

VP të Gad. Ballkanik

JL të Gad. Ballkanik

JP të Gad. Ballkanik

2. Krahaso sipërfaqen e Shqipërisë me atë të vendeve fqinje. Sa herë kanë dallime?

3. Lidh me shigjeta, llojin me gjatësinë e vijës kufitare të Shqipërisë:

Tokësor 316 km

Detar 657 km

Lumor 73 km

Liqenor 48 km

4. Cilat qendra kanë lulëzuar në kohën ilire. Trego si quhen sot këto qendra?

a. Buthroti - _____

b. Dyrrah - _____

c. Lisusi - _____

d. Skutari - _____

e. Lissus - _____

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimmhdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimmhdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 23

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI


Shkalla e kurrikulës: 4

Klasa: IX

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Shqipërisë

Rezultati i të nxënës të temës

- Dallon karakteristikat kryesore gjeotektonike.
- Përshkruan përbërjen kryesore të ndërtimit gjeologjik të Shqipërisë.
- Dallon njësitë kryesore relievore që përbëjnë territorin e vendit.
- Analizon shtrirjen dhe ndikimin e klimës nga jugu në veri dhe nga perëndimi në lindje të vendit.
- Dallon objektet kryesore ujore (detet, liqenet, lumenjtë, etj.).
- Përshkruan përhapjen dhe plleshmërinë e tokave.
- Shpjegon përhapjen e bimësisë dhe të shtazëve, si dhe faktorët ndikues të përhapjes.

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkollës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.

2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veçoritë natyrore të Republikës së Shqipërisë

Fjalët kyçe: Shqipëria, brezi alpin, relievi, malet dhe fushat, luginat, kushtet klimatike, hidrografike, tokat e bimësia.

Rezultati/et e të nxëniti për orë mësimore:

1. Përshkruan pozitën e Shqipërisë në raport me strukturat kryesore gjeotektonike në Ballkan dhe pasojat e saj.
2. Shpjegojnë mënyrën e krijimit të relievit të Shqipërisë sipas periudhave të caktuara.
3. Interpretin faktorët klimatikë dhe tregojnë ndikimin në përhapjen e tokave dhe bimësisë në Shqipëri.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Identifikon në hartën shtetet me të cilat kufizohet Shqipëria;
2. Tregon pozitën gjeografike të Shqipërisë në hartë;
3. Identifikon me hartë zonat kryesore malore të Shqipërisë;
4. Tregon në hartë shtrirjen e Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë;
5. Shpjegon përhapjen e klimës në territorin e Shqipërisë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Punë në grupe "Xhiksou"

Mësimdhënësi ndan nxënësit në tri grupe (grupe familjare), ku secili nxënës ka një numër 1, 2, 3. Pasi nxënësit të jenë përcaktuar sipas numrave, bashkohen njëshat bashkë (1), dyshat bashkë (2) dhe treshat bashkë (3) që njihen si "grupet e ekspertëve".

Mësimdhënësi i jep secilit grup nga një detyrë (fleta me pyetje dhe detyra) që janë pjesë e tekstit që do të shtjellojnë. Nxënësit lexojnë pjesën e caktuar për kohë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar. Pas "ekspertizës", nxënësit kthehen në grupet amë (familjare) dhe për një kohë të shkurtër i shpjegojnë njëri-tjetrit njohuritë e tyre për njësinë. Pjesët me ngjyra në libër: "faktet" dhe "Gjeografia për kureshtarë" dhe "bota bimore dhe shtazore" i lexojnë të gjitha grupet.

Aktiviteti ndahet sipas kohës: Pjesa e parë 5 minuta, pjesa e dytë 25 minuta dhe pjesa e tretë 15 minuta.

Kjo teknikë mund të përdoret në tri etapat e orës. Nëse modifikohet mund të përdoret vetëm në pjesën shtjelluese të orës.

Pjesa e dytë: (punë në grupe).

Grupi 1 (pozita dhe relievi)

- Shpjegoni me pak fjalë ndërtimin gjeologjik të Shqipërisë.
- Përshkruaj relievin e Shqipërisë.
- Sa është lartësia mesatare mbidetare në Shqipëri?
- Cila është maja më e lartë malore në Shqipëri dhe sa metra është?
- Cilat janë fushat (ultësirat dhe fushëgropat) kryesore në Shqipëri?
- Cilat janë luginat akullnajore më të njohura?

Grupi 2 (klima dhe hidrografia)

- Cilat janë elementet klimatike?
- Çka paraqet klima?
- Cilët janë faktorët e klimëformimit në Shqipëri?
- Çfarë klime mbizotëron në pjesën bregdetare të Shqipërisë?
- Cilat janë specifikat e klimës mesdhetare dhe malore?
- Sa është gjatësia bregdetare në Shqipëri?
- Formo tabelë dhe rendit 8 lumenjtë kryesorë të Shqipërisë.
- Sa liqene natyrore ka në Shqipëri?
- Formoni një tabelë dhe kategorizoni liqenet sipas origjinës së formimit.

Grupi 3 (Tokat dhe B.bimore e shtazore)

- Në cilën zonë paraqiten tokat më të mira?
- Tregoni shtrirjen vertikale të tokave në Shqipëri.
- Sa lloje bimësh hasim në Shqipëri?
- Tregoni përqindjen e llojeve të bimëve duke e krahasuar me G. Ballkanik dhe Evropën.
- Paraqitni zonalitetin vertikal të bimësisë (katet bimore) në Shqipëri.
- Cilat janë parqet kryesore kombëtare në Shqipëri?
- Tregoni disa lloje të kafshëve që rriten në hapësirën e Shqipërisë.

-Grupet në fund të pjesës së dytë dorëzojnë detyrën në grup te mësimdhënësi.

Pjesa e tretë: (reflektim në grupe)

Të lexohen punimet/detyrat e grupeve, gjithnjë duke i përcjellë me hartë nëse kërkohet.

Nxënësit e tjerë pasi dëgjojnë prezantimin, mund të drejtohen me pyetje për informacion shtesë nëpërmjet udhëheqësit të grupit. Gjithashtu edhe mësimdhënësi për të kuptuar më shumë mund t'ju drejtohet me pyetje, gjithnjë duke pasur parasysh kohën që kemi në dispozicion.

Mësimdhënësi i vlerëson nxënësit si grup dhe si punë individuale, gjithnjë duke i respektuar kriteret e parashtruara. Mbani shënime në listën e kontrollit ose ndonjë instrument specifik më të përshtatshëm për punën tuaj gjatë vlerësimit të vazhdueshëm.

Detyrë shtëpie: Plotëso në fletore të punës: SHQIPËRIA – VEÇORITË NATYRORE.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupe. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 24

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Testoni njohuritë: Shqipëria (Veçoritë natyrore)

Mësimdhënësi sjell të gatshme fletët e punës për aktivitetin. Nxënësit gjatë punës mund të përdorin vetëm atlasët. Puna individuale dhe pa ndihmën e teksteve, vetëm me ndihmën e hartës



Nëpër territorin e Shqipërisë ka kaluar rruga e cila lidhte Romën dhe Bizantin. Kjo rrugë quhej:

- A. Rruga e Kombit
- B. "Via Pompei"
- C. "Via Egnatia"
- D. Korridori 66

2. Shqipëria ka vijë kufitare 1094km. Kjo vijë kufitare përfshin:

- A. 657km janë kufij tokësorë, 420 km kufij detarë, 28 km kufij lumorë dhe 17 km kufij liqenorë.
- B. 657km janë kufij tokësorë, 316 km kufij detarë, 48 km kufij lumorë dhe 73 km kufij liqenorë.
- C. 644km janë kufij tokësorë, 450 km kufij detarë.
- D. 567 km janë kufij tokësorë, 316 km kufij detarë, 48 km kufij lumorë dhe 163 km kufij liqenorë.

3	• Shqipëria ka sipërfaqe 10,887km ² .	V	G
	• Lartësia mesatare mbidetare e Shqipërisë është 708m.	V	G
	• Shqipëria është më e madhe se Kosova rreth 2.63 herë.	V	G
	• Shqipëria është vendi më i varfër në Evropë me ujëra.	V	G
4	Dalloni fushat e brendshme të Shqipërisë nga ato të Ultësirës Perëndimore: me numër; 1 - Fushat e brendshme; me numër; 2 - Fushat e Ultësirës Perëndimore.		

E Matit Fusha e Shkodrës E Tiranë-Lezhës E Prespës
 E Kolonjës E Korçës E Durrësit
 E Elbasanit E Tropojës E Myzeqesë

5 Përshkruaj me fjalë klimën e Shqipërisë P←→L?

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 25

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë–shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë

Rezultati i të nxënit të temës

- Analizon karakteristikat kryesore të popullsisë së Shqipërisë (natalitetin, mortalitetin, shtimin natyror, strukturën etnike, moshore, gjinore dhe përkatësinë fetare).
- Krahason ngjashmëritë e tkurrjes së territoreve shqiptare në jug të vendit, sikur ato në veri të Kosovës dhe verilindje apo edhe veriperëndim të Shqipërisë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: ✎ _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Popullsia e Shqipërisë

Fjalët kyçe: Lëvizja e numrit të popullsisë, struktura e popullsisë, emigrimi, shkalla e urbanizimit.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Shpjegon trendet e rritjes së popullsisë së Shqipërisë sipas kohëve.
2. Krahasojnë dallimet regionale të dendësisë së popullsisë dhe shpjegon nivelin e urbanizimit dhe ndryshimet që ndodhën.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Radhitë sipas madhësisë pesë qendrat më të mëdha në Shqipëri;
2. Tregon me anën e përqindjes përkatësinë fetare të popullsisë;
3. Shpjegon në përqindje strukturën etnike të popullsisë në Shqipëri.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Stuhi mendimesh

Mësimdhënësi fillon mësimin duke shfrytëzuar fjalët kyçe që janë paraqitur në fillim të tekstit. Kështu mësimdhënësi fillon një diskutim me nxënësit duke i drejtuar që të identifikojnë njësinë e re që do të zhvillohet.

Kjo bëhet përpara se nxënësit të identifikojnë njësinë e re. Paraprakisht, ai shënon në tabelë fjalët kyçe.

Jepuni kuptim fjalëve të shënuara në tabelë (të diskutohet në klasë së bashku me nxënës):

Shtim natyror?

Shtimi mekanik?

Ilirët?

Dendësi?

Migrime?

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi drejton njërin nga nxënësit ose lexon vetë me zë pjesën e njësisë (paragrafin). Kur përfundon leximi, diskutohet për atë se çka u lexua, gjithnjë duke shpjeguar me hartë nëse kërkohet.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përmbajtjes:
 - Kush ishin paraardhësit e shqiptarëve?
 - Sa banorë kishte Shqipëria sipas të dhënave të vitit 2019?
 - Pse, krahasuar me trendet e rritjes në Shqipëri, dalin 1.1 milionë banorë më pak?
- Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës/paragrafit 2, 3...
 - Cila është struktura moshore e popullsisë në Shqipëri?
 - Cila është dendësia mesatare e popullsisë në Shqipëri?
 - Në cilat pjesë Shqipëria ka dendësi më të madhe?
 - Cila është struktura etnike e popullsisë në Shqipëri?
 - Tregoni me hartë qendrat (qytetet) më të mëdha në Shqipëri.
- Pas leximit të fundit, nxënësve mësimdhënësi duhet t'u japë mundësi që ata të flasin me njëri-tjetrin e jo përmes ti. Këtë e arrin duke dhënë pyetjet dhe duke miratuar përgjigjet me lëvizje të kokës.

Pjesa e tretë: Punë individuale.

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të plotësojnë fletoren e punës.

Shqipëria ishte e banuar mjaft herët. Nga kush banohej që nga lashtësia? _____

Rritja më e madhe e popullsisë ishte në periudhën: _____

Çfarë ndodhi me numrin e popullsisë pas vitit 1990? _____. Pse? _____

Çfarë do të ndodhë me numrin e popullsisë pas vitit 2021? Jepni ndonjë shpjegim? _____

Në fund, pasi shumica i kanë plotësuar, mësimdhënësi kërkon nga një nxënës vullnetar që t'i interpretojë të gjithë pjesën në fletore të punës. Kjo si ndihmë për nxënësit që nuk e kanë të qartë ose që kanë përgjigje gjysmake.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 26

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë

Rezultati i të nxënimit të temës

- Identifikon pasuritë natyrore të Shqipërisë dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik.
- Dallon fushat kryesore me potencial bujqësor dhe me ndikim në ekonominë e vendit.
- Dallon fazat kryesore të zhvillimit socio-ekonomik dhe politiko-kulturor të Shqipërisë që nga pavarësia e saj deri në ditët e sotme.
- Analizon ndryshimin e madh në procesin politik, ekonomik dhe të migrimeve në fillimin e viteve të '90-ta të shekullit XX.

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zhvillimi ekonomik i Republikës së Shqipërisë

Fjalët kyçe: Hidroenergji, metalurgji, bujqësia, turizmi

Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore:

1. Analizon rolin e faktorëve natyrorë dhe historiko-politikë në zhvillimin ekonomik.
2. Evidenton faktorët natyrorë për zhvillimin e bujqësisë.
3. Identifikon llojet kryesore të energjisë.
4. Përshkruan motivet kryesore turistike të Shqipërisë.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Ilustron në formë grafiku strukturën e tokave bujqësore në Shqipëri;
2. Numëron bimët kryesore industriale në Shqipëri;
3. Liston pesë resurset kryesore mineralike që është e pasur Shqipëria;
4. Identifikon në hartë zonat kryesore të burimeve të kromit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Mësimdhënësi fillon orën duke e përsëritur njësinë e kaluar në formën e diskutimit. Për kohën sa është duke u zhvilluar diskutimi, synohet që të ndërlihdet me njësinë e re që do të zhvillohet, pjesën e migrameve dhe “Popullsia e Shqipërisë”.

-Kush ishin të parët tanë?

-Cila pjesë e Shqipërisë ka dendësi më të madhe?

-Tregoni disa arsye pse Shqipëria kishte shtim të lartë natyror.

Ndërlidhje me pjesën shoqërore:

-A mund të ndikojë shtimi natyror në zhvillimin e ekonomisë së një vendi?

-Për çka shquhet Shqipëria?

-A i dini disa resurse natyrore të Shqipërisë?

...

Kështu nxënësit njoftohen që do të zhvillohet pjesa shoqërore e Azisë Jugperëndimore, si vazhdim i njësisë së kaluar.

Mësimdhënësi, gjatë diskutimit, shënon fjalët kyçe në tabelë që më vonë të përdoren si pikë referimi ose si njohuri që nxënësit e kishin të njohur.

Pjesa e dytë: Udhëzohen nxënësit të lexojnë njësinë e re duke i përdorur shenjat e INSERTIT: (v) - informacion i njohur, (+) - informacion i ri, (-) - informacion që ndryshon nga ai që e di, (?) - sqarime për informacion të paqartë. Pastaj diskutojnë me radhë se cilat informacione ishin të njohura, cilat të reja dhe sqarohen pyetje nga mësimdhënësi, të shënuara nga nxënësit.

v	+	-	?
(v) Informacion i njohur	(+) Informacion i ri	(-) Informacion që ndryshon nga ai që e di	(?) sqarime për informacionin

Pjesa e tretë: Të plotësohet fletorja e punës, te pjesa e *Zhvillimit ekonomik të Shqipërisë*.

Puna të bëhet individuale dhe për kohë të caktuar, 15’.

Shih hartën e bujqësisë në Shqipëri dhe nxjerr disa përfundime.

Cilat kultura mbillen kah perëndimi? Cilat kultura kah lindja? Po në zonën kodrinoro-malore, çka kultivohet më së shumti? Përgjatë detit Jon?

Identifikoni në hartën e punës zonat kryesore të vendndodhjes së këtij mineralit të kromit: Masivin e Tropojës, Hasit, Kuksit, Bulziqës dhe Shebenikut.

Detyrë shtëpie: Të hulumtohet për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë me arsyen që orën e radhës do të hartohet një shkrim me të njejtën temë mësimore.

Shkrimi duhet ti përmbahet kriterëve, si:

Kriteret teknike:

Drejtshkrimi

Pesë dëshmi të reja jashtë librit bazë (hulumtim në internet - nga burime të vlefshme).

Artikulimi i tekstit duke u bazuar në renditje.

Pikat e hulumtimit:

Faktorët kryesor të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë

Veçoritë e zhvillimit të bujqësisë

Metalurgjia në Shqipëri

Zhvillimi industrial në Shqipëri

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimitdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimitdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 27

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4

Klasa: IX

Tema: Veçoritë –shoqërore dhe ekonomiketë Shqipërisë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veprimtari praktike: Ekonomia e Shqipërisë

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Harton një tekst në një fletë A4 sipas temës së dhënë gjithnjë duke respektuar kriteret e dhëna paraprakisht nga mësimitdhënësi.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: atlas, harta

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Punë individuale - Hartim/Shkrim i lirë (tema e caktuar një javë më herët nga mësimdhënësi).

Mësimdhënësi pajis nxënësit me nga një fletë A4, në të cilën kërkon që si fillim të shënohet tema, data dhe emri e mbiemri. Koha që kanë në dispozicion duhet të jetë deri në 35’.

Hartimi duhet t’i përmbahet kriterëve që janë dhënë një orë më herët, ku për siguri, mësimdhënësi i shënon në tabelë.

Tema: Republika e Shqipërisë

Kriteret teknike:

Drejtshkrimi

Pesë dëshmi të reja jashtë librit bazë (hulumtim në internet - nga burime të vlefshme).

Artikulimi i tekstit duke u bazuar në renditje.

Pikat e hulumtimit:

Faktorët kryesor të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë

Veçoritë e zhvillimit të bujqësisë

Metalurgjia në Shqipëri

Zhvillimi industrial në Shqipëri

Nxënësit para vetës duhet të kenë vetëm ATLASËT gjeografike dhe stilolapsin.

Nëse kanë hulumtuar për të dhëna të reja nga interneti dhe që janë shifra, atëherë mësimdhënësi u lejon nxënësve të marrin përshkrime të shkurta/shifra në letër që të mos ngarkohen për t’i mbajtur në mend. Kjo vlen vetëm për informacionin e fituar nga hulumtimi.

Lexim i hartimit/shkrimit/ese-së

Mësimdhënësi, për kohën e mbetur, mbledh shkrimet dhe cakton/përzgjedh vetëm tre nxënës të lexojnë punimin. Kjo përzgjedhje bëhet gjatë vrojtimit të punës, gjatë kohës që ata punojnë. Pjesën tjetër e mban si dëshmi të punës së tyre dhe mund ta konsultojë gjatë vlerësimit për ditët në vijim. Mësimdhënësi, në shtëpi, i vlerëson shkrimet dhe i mban si dëshmi për nxënësit.

Testimi i dytë

RREGULLAT GJATË TESTIMIT		No. 28	
•Mos komuniko me shoqen apo shokun; •Kujdes në rrumbullaksim e alternativave; •Vetëm një alternativë është e saktë; •Shëno shkrimin e lexueshëm; Mos e dëmto testin; •Respektoje kohën.			
Tema: 1: Ballkani (20%) 2: Kosova (80%)			--
<i>Sqarim: Testi shërben vetëm si shembull. Mësimdhënësit i mbetet të formulojë një test të tillë duke ia përshtatur temave të tij.</i>			SHEMBULL
<i>Klasa – IX</i>		Emri dhe	
		Mbiemri: _____	
		Pikët	
1	Lumi më i gjatë në G. Ballkanik është: b) Lumi Po b) Vollga c) Sena d) Danubi	8	
2	Bashko me vija lumenjtë me detin përkatës: a. Nerodima Adriatik b. Sitnica Egje c. Toplluha Deti i Zi	8	
3	Sipas origjinës, si ndahen liqenet në Kosovë: _____	9	
4	Nëse ndodheni në Prishtinë, atëherë qyteti i Pejës për ju është: a) në veri b) në perëndim c) në lindje	9	
5	Cila nga alternativat e paraqet të saktë kuptimin për bifurkacionin: d) Bifurkacioni paraqet ndarjen e qytetit në dy pjesë nga lumi ; e) Bifurkacioni paraqet ndarjen e liqenit në dy pjesë.; f) Bifurkacioni paraqet ndarjen e lumit në dy lumenj, përkatësisht në dy pellgje.	9	
6	Përshkruani rrjedhën e lumit Danub gjatë tërë territorit ballkanik. _____ _____	10	
7	Analizo grafikun dhe sipas numrave shkruaj lumenjtë që kërkohen në hartë: 1 _____ 2 _____ 3 _____ 4 _____	11	

		5 _____					
8		Regjioni Perëndimor	Prishtina Drenica Prizreni Lumi Drin Anamorava	Gjakova Sitnica Mitrovica Dushkaja Pashtriku	Regjioni Lindor	11	
	<i>Rendit elementet përkatëse te regjioni përkatës.</i>						
9	“Bjeshkët e Nemuna”	2656m	Jugperëndim	Ereniku		12	
	Plotëso tabelën duke shfrytëzuar fjalët kyçe që janë dhënë dhe jepi kuptim asociacionit.						
10	Vlerësoni rolin e resurseve natyrore për zhvillimin ekonomik të Kosovës. _____						13
<i>Për qinda</i>	0 - 39 %	40% - 59 %	60% - 79%	80% - 89%	90% - 100 %	Pikët: ()	
<i>Pikët</i>	0 -39 pikë	40 - 59 pikë	60 - 79 pikë	80 - 89 pikë	90 – 100 pikë		
<i>Nota</i>	1	2	3	4	5	()	
Shenjat korigjuese: √- e saktë, x- e pasaktë, ~- e paplotësuar				Mësimdhënësi: _____ _____			

Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve - Klasa IX

Fusha/Tema mësimore		Njohja	Të kuptuarit	Zbatimi	Mendimi kritik	Shuma
		20%	30%	10%	40%	100%
Gadishulli Ballkanik	20%	2 (16p)	1 (9p)	1 (10p)	Analizë - 1 (11p) Analizë - 1 (11p)	3 (57p)
Veçoritë natyrore dhe shoqërore të Kosovës	80%		2 (18 p)		Sintezë - 1 (12p) Vlerësim - 1 (13p)	4 (43p)
Totali i pikëve	100%	16 pikë	27 pikë	10 pikë	47 pikë	100 pikë

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE


No: 30

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Veçoritë –shoqërore dhe ekonomike të Shqipërisë

Rezultati i të nxënit të temës

•Vlerëson potencialin turistik të Shqipërisë (zonën bregdetare, zonat e tjera malore dhe bukuritë e veçanta natyrore e kulturore).

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Transporti, tregtia e jashtme dhe turizmi

Fjalët kyçe: Transport i mallrave, turizëm balnear, turizëm shëndetësor, telekomunikacion.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Shpjegon me hartë shtrirjen e rrjetit rrugor dhe hekurudhor në hapësirën e Shqipërisë.
2. Diskuton rolin e importit dhe eksportit dhe tregon rëndësinë e tyre në zhvillimin e turizmit.
3. Interpretet objektet e ofertës natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit në Shqipëri.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gathtë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Numëron pesë faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin e turizmit;
2. Vlerëson tre llojet kryesore të transportit sipas zhvillimit të tyre në Shqipëri;
3. Identifikon pesë qendrat kryesore turistike në Shqipëri.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Diskutim në klasë

Mësimdhënësi fillon orën duke parashtruar pyetje për diskutim me nxënësit. Pyetjet lidhen me njësinë që do të zhvillohet.

-Ç'kuptoni me transport?

-Cilat lloje të turizmit i dini, që zhvillohen në Shqipëri?

-A ka qenë dikush nga ju për vizitë në ndonjë vend në Shqipëri dhe cili ka qenë motivi?

-Çka mendoni, a kanë lidhje mes vete transporti, tregtia dhe turizmi?

Gjatë diskutimit, përdorni hartën që nxënësit t'i gjejnë vendet të cilat i përmendin.

Gjatë kohës së diskutimit, shënoni disa fjalë kyçe në tabelë.

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të lexojnë tekstin individualisht dhe në heshtje.

Duke marrë parasysh që janë dy njësi mësimore, mësimdhënësi ndan në 2 paragrafe tekstin dhe drejton nxënësit të lexojnë vetëm pjesën e tyre.

Gjatë kohës që nxënësit lexojnë, mësimdhënësi shënon disa pyetje në tabelë.

Pasi të lexohet teksti, nxënësit, në formë vullnetare plotësojnë me përgjigje tabelën. Mësimdhënësi miraton përgjigjet nëse janë të sakta.

Pyetje	Komente
1. Çka paraqet turizmi?	
2. Përmendi faktorët natyrorë të cilët kanë mundësuar zhvillimin e bujqësisë.	
3. Tregoni tri zona të turizmit malor në shqipëri.	
4. Cilët janë portet kryesore në Shqipëri?	
5. Cilat forma të turizmit po zhvillohen kohëve të fundit në Shqipëri?	
6. Shenjoni në hartë qendrat kryesore të turizmit bregdetar.	

Pjesa e tretë: Mësimdhënësi parashtron një çështje para klasës, ku u kërkon nxënësve që të argumentojnë pse janë *pro* ose *kundër* çështjes, duke i shënuar në organizuesin grafik. Mendimet do të shkëmbehen në dyshe e në katërshë. Klasa do të pozicionohet në dy grupe, ku nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre.

Bëhet një raportim para klasës për arsyet që janë zgjedhur *pro* ose *kundër* çështjes. Për çdo paraqitje caktohet një kufi kohor prej një minute. Gjatë kohës që dy grupet raportojnë arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion dhe të shkojnë në grupin që ka arsyet më bindëse.

A mendoni që Republika e Shqipërisë në një të ardhme të afërt do të quhet “perla e Evropës” për turizëm?

PO

JO

Diskutoni pse PO dhe pse JO (pranohen arsyetime të shkurta). Në fund tregoni rezultatin sa kanë shprehur mendimin që PO dhe sa që JO.

Në formën e diskutimit mund të bëhet dallimi në mes të kaluarës dhe të tashmës për turizmin në Shqipëri.

Për fund i pyet: A ka ndryshuar dikush mendim?

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimitdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimitdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 29

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4

Klasa: IX

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Prezantim i punimeve: Republika e Shqipërisë

Prezantim i punimeve në dyshe, në Poëer Point.

Punimi duhet t’u përmbahet kriterëve që mësimitdhënësi i ka paraqitur me detyrën, disa orë (dy javë) më herët.

Vlerësimi i punës

Për të nxjerrë notën veprojmë kështu (shembull):

$3 \times 0.20 + 5 \times 0.20 + 4 \times 0.10 + 5 \times 0.30 + 3 \times 0.20 = 0.60 + 1 + 0.40 + 1.5 + 0.60 = 4,1$ pra nota është 4

Emri i nxënësit	Ilustrimet 20%	Burimet 20%	Artikulimi 10%	Shpjegim 30%	Bashkëpunimi 20%	Nota
1	3	5	4	5	3	4
2						
3						
4						

Mësimitdhënësi mund të formojë një instrument sipas kriterëve të veta ose t’i paraqesë kriteret së bashku me nxënësit.

Instrumenti 3 - Prezantim me gojë (30%). Nxënësi vlerësohet sipas standardeve të vlerësimit, të përshkruara në UA, Kurrikulën bërthamë dhe Udhëzuesin për vlerësim.

Nota 5. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin dhe ofron fakte, argumente dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve. Ofron faktet gjeografike, njih objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehjetë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik.

Nota 4. Nxënësi i cili bashkëbisedon me arsimtarin dhe ofron fakte dhe e analizon detyrën para se të përgjigjet. Ka shprehje të rrjedhshme dhe logjike, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell me gjestikulacion për eksplikim të rasteve, jo në formë shumë të saktë. Ofron faktet gjeografike, njih objektet gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; analizon lidhshmëritë dhe ligjshmëritë gjeografike që shprehen dhe veprojnë brenda këtyre njësive; paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehjetë, të dinë të shërbehen me to dhe të përvetësojnë mënyrën e të menduarit gjeografik jo shumë të saktë.

Nota 3. Nxënësi i përgjigjet pyetjeve të arsimtarit, por jo mjaftueshëm. Ka shprehje të rrjedhshme dhe deri diku të logjikshme, me ngecje në informacion. Bashkëbisedimin e përcjell më me ngecje nga mungesa e leximit të mjaftueshëm. Ofron faktet gjeografike, njih disa objekte gjeografike; shpjegon dukuritë dhe proceset gjeografike (ato që i di) si dhe raportet që janë në lidhshmëri me njësitë e përpunuara hapësinore; Paraqet aftësitë, shkathtësitë e shprehjetë, të dinë të shërbehen me to.

Nota 2. Nxënësi mundohet të bisedojë, ofron fakte gjatë bisedës, por shumë pak. Vërehet mungesa e leximit, nuk i plotëson as 30% të kriterëve të lartpërmendura.

Nota 1. Nxënësi nuk u përgjigjet pyetjeve, nuk bashkëbisedon. Nuk i plotëson kriteret e lartpërmendura as 20%.

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 31

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Regjionet gjeografike të Shqipërisë

Rezultati i të nxënit të temës

- Analizon shtrirjen e vendbanimeve kryesore në raport me veçoritë relievo të Shqipërisë.
- Dallon regjionet gjeografike dhe tiparet kryesore të tyre.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Regjionet gjeografike - Regjioni i Ultësirës Perëndimore

Fjalët kyçe: Regjion, Ultësira Perëndimore, Myzeqeja, moçalet.

Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore:

1. Analizon procesin e regjionalizimit gjeografik në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Diferencon tërësitë kryesore natyrore dhe gjeografike brenda këtij regjioni.
3. Evidenton pasuritë kryesore natyrore të këtij regjioni dhe shpjegon punën e njeriut në transformimin e peizazhit bregdetar.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Shpjegon me hartë pozitën e Ultësirës Perëndimore;
2. Identifikon lumenjt që rrjedhin në këtë regjion;
3. Numëron fushat që janë pjesë e Ultësirës Perëndimore dhe identifikon në hartë;
4. Tregon pozitën gjeografike të tri qendrave më të mëdha të regjionit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Shpjegim i hartës

Mësimdhënësi fillon orën duke parashtruar pyetje për diskutim me nxënësit.

Pyetjet lidhen me njësinë që do të zhvillohet.

- Çka paraqet ngjyra e gjelbër në hartën fizike të Shqipërisë?
- Identifikoni qendrat në Ult. Perëndimore.
- Në gjeografi, çka quajmë ultësirë?
- Ku janë paraqitur zonat malore në hartë?


Para klasës paraqet hartën e Shqipërisë dhe kërkon nga nxënësit që të identifikojnë qytetet që gjenden në pjesën e Ultësirës Perëndimore.

Të gjithë qytetet e identifikuar shënohen në tabelë.



Pjesa e dytë: Klaster (punë individuale).

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Regjioni i Ultësirës Perëndimore) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës. Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të papërshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.



Vërejtje: Klasteri është paraqitur vetëm si shembull.

Pjesa e tretë: Shkrim i lirë (15’).

Tema: Regjioni i Ultësirës Perëndimore (përmbledhje pa libër, me atlas)

Gjatë shkrimit të lirë, nxënësit shkruajnë pa u ndalur, me qëllim që të shkruarit e tyre të burojnë në mënyrë të tillë që ata të mos kenë frikë nga kritikën dhe korrigjimet.

Fletat dorëzohen dhe merren në shtëpi nga arsimtari që t’i vlerësojë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 32

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Regjionet gjeografike të Shqipërisë

Rezultati i të nxënit të temës

- Analizon shtrirjen e vendbanimeve kryesore në raport me veçoritë relievo të Shqipërisë.
- Dallon regjionet gjeografike dhe tiparet kryesore të tyre.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krahina Malore Qendrore e Shqipërisë

Fjalët kyçe: Malet, lumenjtë, qafat, parqet kombëtare

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Trajton veç e veç tërësitë kryesore malore të kësaj krahinë duke përdorur hartën e punës.
2. Analizon rolin e relievit në zhvillimin e veprimtarive njerëzore.
3. Identifikon në hartën e punës parqet kombëtare të regjionit dhe tregon aktivitetet kryesore ekonomike të regjionit.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Shpjegon me hartë pozitën tërësive kryesore malore të kësaj krahinë;
2. Identifikon lumenjtë që rrjedhin në këtë regjion;
3. Numëron parqet kombëtare të regjionit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Mësimdhënësi fillon orën duke e përsëritur njësien e kaluar në formën e diskutimit. Për kohën sa është duke u zhvilluar diskutimi, synohet që të ndërlihet me njësien e re që do të zhvillohet, pjesën “Krahina Malore Qendrore e Shqipërisë”.

1. Si është formuar regjioni i Ultësirës Perëndimore?
2. Përmendi tërësitë më të vogla natyrore në kuadër të këtij regjioni?
3. Ku shtrihet fusha e Myzeqesë?
4. Cilat forma të relievit dominojnë në pllajën e Dumresë?

Ndërlidhje me pjesën shoqërore:


- Gjeni në hartë lumin Drin dhe lumin Devoll?
- Identifikoni qytetet në hapësirën mes këtyre dy lumenjve?
- Përshkruani relievin nga ajo që shihni në hartë?

Kështu, nxënësit njoftohen që do të zhvillohet pjesa ekonomike për Republikën e Kosovës.

Pjesa e dytë: Klaster (punë individuale).

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Krahina Malore Qendrore e Shqipërisë) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.

Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të papërshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.



Vërejtje: Klasteri është paraqitur vetëm si shembull.

Pjesa e tretë: Shkrim i lirë (15’).

Tema: Krahina Malore Qendrore e Shqipërisë (përmbledhje pa libër, me atlas).

Gjatë shkrimit të lirë, nxënësit shkruajnë pa u ndalur, me qëllim që të shkruarit e tyre të burojnë në mënyrë të tillë që ata të mos kenë frikë nga kritikët dhe korrigjimet

Fletat dorëzohen dhe merren në shtëpi nga arsimtari që t'i vlerësojë.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimmhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimmhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 33

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi Lënda: GJEOGRAFI Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Tema: Regjionet gjeografike të Shqipërisë

Rezultati i të nxënës të temës

- Analizon shtrirjen e vendbanimeve kryesore në raport me veçoritë relievo të Shqipërisë.
- Dallon regjionet gjeografike dhe tiparet kryesore të tyre.

Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.

3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për të eksploruar dhe për të krahasuar ndryshimet dhe ngjashmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativo-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krahina Malore Veriore dhe Jugore e Shqipërisë

Fjalët kyçe: Alpet shqiptare, klima, pejzazhet malor, turizmi

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

1. Identifikon në hartën fizike malet dhe luginat kryesore lumore dhe analizon veçoritë kryesore natyrore të krahinës.
2. Tregon tiparet më të rëndësishme të pejsazhit natyror dhe aktivitetet kryesore ekonomike.
3. Analizon të dhënat demografike dhe ekonomike për qendrat kryesore urbane sipas tabelave.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimmhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Përkufizon me hartë pozitën gjeografike të krahinës;
2. Identifikon lumenjt që rrjedhin në këtë regjion;
3. Numëron parqet kombëtare të regjionit;
4. Liston pesë qendrat më të banuara të regjionit.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlasit, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Mësimdhënësi fillon orën duke e përsëritur njësinë e kaluar në formën e diskutimit. Për kohën sa është duke u zhvilluar diskutimi, synohet që të ndërlidhet me njësinë e re që do të zhvillohet, pjesën “Krahina Malore Qendrore e Shqipërisë”.

1. *Si është formuar regjioni i Ultësirës Perëndimore?*
2. *Përmendi tërësitë më të vogla natyrore në kuadër të këtij regjioni?*
3. *Ku shtrihet fusha e Myzeqesë?*
4. *Cilat forma të relievit dominojnë në pllajën e Dumresë?*

Ndërlidhje me pjesën shoqërore:

- Gjeni në hartë lumin Drin dhe lumin Devoll?*
- Identifikoni qytetet në hapësirën mes këtyre dy lumenjve?*
- Përshkruani relievin nga ajo që shihni në hartë?*


Kështu nxënësit njoftohen që do të zhvillohet pjesa ekonomike për Republikën e Kosovës.

Pjesa e dytë: Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të punojnë në bashkëpunim (punë në dyshe) dhe udhëzon ata që të lexojnë pjesën e caktuar nga mësimdhënësi (1-Krahina Malore Veriore, 2- Krahina Malore Jugore).

Pas leximit, duke bashkëpunuar mes vete, secili reflekton në pika të shkurta informacionin për krahinën përkatëse për të plotësuar detyrën me “Diagrami i Venit”.

Në fazën e dytë kërkohet nga nxënësit të krahasohen dhe të gjejnë të përbashkëtat në mes të këtyre tri shteteve në formën e diagramit të venit.

Pjesa e tretë: Punë individuale.



Të plotësohen detyrat në fund të tekstit, në formë individuale, dhe të dorëzohen te mësimdhënësi për kohë të caktuar.

1. Si është krijuar relievi në Alpet Shqiptare?
 2. Ku shtrihen Alpet Lindore?
 3. Cilët lumenj rrjedhin nëpër Krahinën Malore Jugore?
 4. Pse Gjirokastra është futur në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s?
- Detyrë: Formoni një listë me qendrat kryesore që gjenden në keto krahina?*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimin, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 34

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Veprimtari praktike me fletore të punës-Regjionet malore të Republikës së Shqipërisë

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit që të punohet në grupe, nga katër nxënës. Secili nxënës duhet të plotësojë pjesën përkatëse të regjionit përkatës.





Plotëso hartën mecece të krahinave (fushat, kodrat, lumenjtë, qendrat kryesore urbane, liqenet, gjiret, kepat, detet etj.)

Nxënësi 1: REGJIONI I ULTËSIRËS PERËNDIMORE

Nxënësi 2: KRAHINA MALORE QENDRORE E SHQIPËRISË

Nxënësi 3: KRAHINA MALORE VERIORE E SHQIPËRISË

Nxënësi 4: KRAHINA JUGORE E SHQIPËRISË



ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 35

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Rezultati i të nxënit të temës

- Shpjegon karakteristikat themelore natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi, duke përfshirë faktorët: ndërtimi gjeologjik, njësitë kryesore morfologjike, objektet kryesore hidrografike, komponentët specifikë dhe përcaktues të klimës, dhe tiparet e biodiversitetit të këtyre vendeve, me theks të veçantë në pjesën e territoreve ku jetojnë shqiptarët.
- Dallon veçoritë kryesore humane (ekonomike, demografike, urbane) të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.
- Dallon degët kryesore ekonomike të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.
- Shpjegon ndikimin e kushteve historike, politike dhe shoqërore në zhvillimin e ekonomisë dhe të degëve kryesore të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.
- Shpjegon pozitën e shqiptarëve në ish-Jugosllavi.
- Dallon strukturën nacionale dhe fetare të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.
- Vlerëson kontekstin historik të ngjarjeve kryesore dhe dëmtimin e truallit dhe etnikumit të shqiptarëve deri më sot.
- Shpjegon për shtrirjen e shqiptarëve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, duke e përdorur hartën.
- Analizon ecurinë dhe sfidat e përbashkëta dhe të veçanta, drejt anëtarësimit në BE të shteteve: R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Malit të Zi dhe të Kosovës e Shqipërisë, krahasuar me to.

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet; 3.1; 3.2.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime, si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme; 4.1; 4.2.

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlihdjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke. 2.1; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Maqedonia Veriore

Fjalët kyçe: Maqedonia e Veriut, Sharri, Vardari, Shkupi.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Analizon veçoritë kryesore natyrore dhe ato shoqërore-ekonomike të Maqedonisë Veriore.
2. Shpjegon rolin e klimës dhe relievit në zhvillimin e degëve të veçanta të bujqësisë.
3. Përshkruan strukturën etnike dhe problemet e brendshme politike.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Përkufizon me hartë pozitën gjeografike të Maqedonisë Veriore;
2. Identifikon lumenjt që rrjedhin në Maqedoninë Veriore;
3. Numëron grupet etnike të popullsisë sipas përqindjes;
4. Tregon pesë qendrat më të banuara me shqiptarë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

Pjesa e parë: “Asociacion”

Arsimtari formon një asociacion në tabelë si vegëz, që nxënësit të gjejnë njësinë që do të zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë.

Nxënësit mund edhe të mos kenë njohuri për elementet e asociacionit, por mësimdhënësi u jep ndihmën që ata t’i gjejnë dhe mësojnë njëkohësisht gjatë diskutimit dhe punës.


A	B	C	D
Tetova	Aleksandri i Madh	Vardari	Tikvesh

Maqedonia Veriore

Pjesa e dytë: Klaster (punë individuale).

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Maqedonia Veriore) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.


Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.



Vërejtje: Klasteri është paraqitur vetëm si shembull.

Pjesa e tretë: Punë me fletore të punës.

Në hartën me mece të Maqedonisë së Veriut, plotëso emërtimet gjeografike.



Rretho qendrat më të banuara me popullsi shqiptare.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësuesi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

No: 36

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda: GJEOGRAFI

Shkalla e kurrikulës: 4 Klasa: IX

Rezultati i të nxënit të temës

- Shpjegon karakteristikat themelore natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi, duke përfshirë faktorët: ndërtimi gjeologjik, njësitë kryesore morfologjike, objektet kryesore hidrografike, komponentët specifikë dhe përcaktues të klimës, dhe tiparet e biodiversitetit të këtyre vendeve, me theks të veçantë në pjesën e territoreve ku jetojnë shqiptarët.
- Dallon veçoritë kryesore humane (ekonomike, demografike, urbane) të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.
- Dallon degët kryesore ekonomike të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.
- Shpjegon ndikimin e kushteve historike, politike dhe shoqërore në zhvillimin e ekonomisë dhe të degëve kryesore të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.
- Shpjegon pozitën e shqiptarëve në ish-Jugosllavi.
- Dallon strukturën nacionale dhe fetare të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi.
- Vlerëson kontekstin historik të ngjarjeve kryesore dhe dëmtimin e truallit dhe etnikumit të shqiptarëve deri më sot.
- Shpjegon për shtrirjen e shqiptarëve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, duke e përdorur hartën.
- Analizon ecurinë dhe sfidat e përbashkëta dhe të veçanta, drejt anëtarësimit në BE të shteteve: R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Malit të Zi dhe të Kosovës e Shqipërisë, krahasuar me to.

Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës: 

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet; 3.1; 3.2.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime, si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme; 4.1; 4.2.

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke. 2.1; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Republika e Malit të Zi

Fjalët kyçe: Mali i Zi, bregdeti, relievi malor, turizmi

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

1. Analizon rolin e pozitës gjeografike në zhvillimin ekonomik të vendit.
2. Shtjellon veçoritë kryesore natyrore të Malit të Zi.
3. Identifikon njësitë kryesore relievo dhe përcakton shtrirjen e tyre.
4. Jep të dhëna për rrugëtimin e Malit të Zi deri te pavarësimi i tij.

Kriteret e suksesit:

Sqarim: Kriteret duhet të përpilohen së bashku me nxënësit në klasë. Mësimdhënësi mund t'i përpilojë edhe në shtëpi dhe t'i sjellë të gatshme atëherë kur njësia është e gjatë dhe dëshiron të kursejë kohën. Kriteret duhet t'i shërbejnë Rezultateve të orës mësimore.

Shembull:

1. Përkufizon me hartë pozitën gjeografike të Malit të Zi;
2. Identifikon në hartë qytetet bregdetare të Malit të Zi;
3. Numëron grupet etnike të popullsisë sipas përqindjes;
4. Tregon me hartë shtrirjen e popullsisë shqiptare në Mal të Zi.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptopi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

Pjesa e parë: “Asociacion”

Arsimtari formon një asociacion në tabelë, si vegëz që nxënësit të gjejnë njësinë që do të zhvillohet dhe të pyesin për rubrikat se çka asociojnë.

Nxënësit mund edhe të mos kenë njohuri për elementet e asociacionit, por mësimdhënësi u jep ndihmën që ata t’i gjejnë dhe mësojnë njëkohësisht gjatë diskutimit dhe punës.


A	B	C	D
Podgorica	288km	Moraqa	Kotorri

Mali i Zi

Pjesa e dytë: Klaster (punë individuale).

Mësimdhënësi udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën (tekstin) e njësisë mësimore që do të zhvillohet. Pasi që lexohet, në tabelë formohet KLASTERI, dhe në qendër të tabelës së zezë shënohet (Maqedonia Veriore) ku nxënësit formojnë degët me anën e informacionit që kuptojnë nga leximi i pjesës.

Mësimdhënësi luan rolin e “arbitrit” duke cilësuar njohuritë e shprehura si të përshtatshme ose të pa-përshtatshme për njësinë. Puna që zhvillohet në tabelë të përshkruhet edhe në fletoret e klasës.




Vërejtje: Klasteri është paraqitur vetëm si shembull.

Pjesa e tretë: Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të formojnë një diagram ku krahasohen dy shtetet ballkanike: Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Të dhënat të jenë sipas elementëve:

Popullsia, Sipërfaqja, Relievi, Pozita gjeografike (koment vlerësues), Ujërat.

Mali i Zi	elementet	Maqedonia Veriore
	←Pozita gjeografike→ Vlerëso me fjalët tuaja pozitën	
	←Relievi→ Komento me vlerësim argumentues për relievin dhe sipërfaqen	
	←Klima→ Vlerëso klimën	
	←Ujërat→ Lumenjtë, liqenet, detet...	
	←Popullsia→	
	←Komenti juaj→ Komente të nxënësve për regionet	
VLERËSIMI I NXËNËSVE		
<p>Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësimsdhënësi kalon në çdo bankë që të vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i pasur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).</p> <p><i>Mësimsdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).</i></p>		

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
No: 37			
Fusha kurrikulare: <u>Shoqëria dhe mjedisi</u>	Lënda: GJEOGRAFI	Shkalla e kurrikulës: 4	Klasa: IX
<p>Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi</p> <p>Rezultati i të nxënit të temës</p> <ul style="list-style-type: none"> •Shpjegon karakteristikat themelore natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi, duke përfshirë faktorët: ndërtimi gjeologjik, njësitë kryesore morfologjike, objektet kryesore hidrografike, komponentët specifikë dhe përcaktues të klimës dhe tiparet e biodiversitetit të këtyre vendeve, me theks të veçantë në pjesën e territoreve ku jetojnë shqiptarët. •Dallon veçoritë kryesore humane (ekonomike, demografike, urbane) të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi. •Dallon degët kryesore ekonomike të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi. •Shpjegon ndikimin e kushteve historike, politike dhe shoqërore në zhvillimin e ekonomisë dhe të degëve kryesore të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi. •Shpjegon pozitën e shqiptarëve në ish-Jugosllavi. •Dallon strukturën nacionale dhe fetare të R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi. •Vlerëson kontekstin historik të ngjarjeve kryesore dhe dëmtimin e truallit dhe etnikumit të shqiptarëve deri më sot. •Shpjegon për shtrirjen e shqiptarëve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, duke e përdorur hartën. •Analizon ecurinë dhe sfidat e përbashkëta dhe të veçanta, drejt anëtarësimit në BE të shteteve: R. së Maqedonisë së Veriut, Serbisë, Malit të Zi dhe të Kosovës e Shqipërisë, krahasuar me to. <p>Tema: Veçoritë e përgjithshme natyrore të Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Malit të Zi</p> <p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:  _____</p>			

Rezultatet e fushës së kurrikulës:

RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet; 3.1; 3.2.

RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme; 4.1; 4.2.

RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke. 2.1; 2.2.

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Serbia

Fjalët kyçe: Serbia, Vojvodina, shtet kontinental, Beogradi.

Rezultati/et e të nxënës për orë mësimore:

1. Shpjegon pozitën gjeografike dhe rolin e saj në rrethana historike, si dhe zhvillimet politike.
2. Diferencon tërësitë kryesore relievo-re të Serbisë.
3. Analizon të dhëna për pasuritë natyrore dhe zhvillimin ekonomik në saje të tyre.
4. Analizon strukturën etnike të popullsisë dhe tregon shtrirjen territoriale të bashkësive etnike.

Kriteret e suksesit:


1. Përkufizon me hartë pozitën gjeografike të Serbisë;
2. Identifikon me hartë lumenjt që rrjedhin në Serbi;
3. Numëron grupet etnike të popullsisë sipas përqindjes;
4. Tregon pesë qendrat më të banuar.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti 9, atlas, harta, projektori, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore apo çështjet ndërkurrikulare: Histori

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

Pjesa e parë: Si fillim i orës, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të shprehin njohuritë e tyre për Serbinë. Në tabelë formohet teknika e KLASTERIT, me në qendër **“SERBIA”**, ku nxënësit degëzojnë ato njohuri që kanë për njësinë e re. Komentet e vlefshme për temën shënohen në tabelë dhe përshkruhen në fletore të klasës.



Pjesa e dytë: Lexohet paragrafi i parë. Kur nxënësit ta përfundojnë leximin e këtij paragrafi, mbyllin tekstin.

- Pas këtij leximi, nxënësve u shtrohen pyetjet varësisht nga natyra e përmbajtjes:
 - Cila është pozita gjeografike e Serbisë?
 - Me cilat shtete kufizohet Serbia?
 - Cilat ish-in arsyet që Serbia iniciante luftëra në G. Ballkanik?
 - Cilat regjione të Serbisë janë pjesë e Evropës së Mesme?
 - Si ndahet Serbia sipas regjioneve gjeografike?

- Tregoni disa lumenj të rëndësishëm në Serbi?
- Në sa tërësi natyrore ndahet Vojvodina. Tregoni në hartë.
- Si është e ndarë Serbia Qendrore?
- Sa është popullsia e Serbisë?
- Me cilat pasuri natyrore shquhet Serbia?

- Gjatë diskutimit, komentet më të logjikshme shënohen në tabelë/*flipchart* dhe shpjegohen me hartë.
- Hapa të njëjtë merren edhe te leximi i pjesës 2, 3... Para leximit të fundit, shtohet edhe pyetja: Çfarë mendoni, si e vlerësoni këtë regjion në krahasim me regjionet e tjera?

Pjesa e tretë: Në fletoren e klasës dhe me hartën e Serbisë, të punohet individualisht.

Gjeni në hartë:

Tërësitë natyrore: **Banati, Baçka dhe Sremi.**

Lumenjt: **Danubi, Tisa, Sava, Morava.**

Zonat malore: **Ballkaniket, Karpitet, Dinarikën.**

1. Ndërmjet cilave shtete ndodhet shteti i Serbisë?

2. Rretho përgjigjen e pasaktë:

- a) Serbia ka pozitë qendrore në Gadishullin Ballkanik
- b) Serbia është shtet kontinental
- c) Lumi i Danubit dhe i Tisës e ndajnë Vojvodinën në tri tërësi
- d) Serbia ka dalje në det e) Banati shtrihet ndërmjet Tisës dhe Danubit.



VLERËSIMI I NXËNËSVE

Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi kalon në çdo bankë dhe vlerëson punën individuale dhe grupore. Nxënësit vlerësohen sipas listës së kontrollit për aktivitetin e tyre gjatë mësimit, gjithnjë duke i patur parasysh kriteret (Vlerësimi individual).

Mësimdhënësi kategorizon nivelin e kriterit gjatë vlerësimit, të saktë (niveli i lartë), pjesërisht të saktë (niveli i mesëm) vetëm pak të saktë (niveli i ulët).

Testimi i tretë

RREGULLAT GJATË TESTIMIT


- Mos komuniko me shoqen apo shokun;
- Kujdes në rrybullaksim e alternativave;
- Vetëm një alternativë është e saktë;
- Shëno shkrimin e lexueshëm;
- Mos e dëmto testin;
- Respektoje kohën.

No. 38

Tema: 1: Ballkani (20%) 2: Kosova (80%)

--Shembull--

Sqarim: Testi shërben vetëm si shembull. Mësimdhënësit i mbetet të formulojë një test të tillë duke ia përshtatur temave të tij.

Klasa – VIII		Emri dhe Mbiemri: _____		Pikët	
1	Lumi më i gjatë në G. Ballkanik është: c) Lumi Po b) Vollga c) Sena d) Danubi			8	
2	Bashko me vija lumenjtë me detet përkatëse: a. Nerodima Adriatik b. Sitnica Egje c. Toplluha Deti i Zi			8	
3	Sipas origjinës, si ndahen liqenet në Kosovë: _____			9	
4	Nëse ndodheni në Prishtinë, atëherë qyteti i Pejës për ju është: a) në veri b) në perëndim c) në lindje			9	
5	Cila nga alternativat e paraqet të saktë kuptimin për bifurkacionin: g) Bifurkacioni paraqet ndarjen e qytetit në dy pjesë nga lumi ; h) Bifurkacioni paraqet ndarjen e liqenit në dy pjesë.; i) Bifurkacioni paraqet ndarjen e lumit në dy lumenj, përkatësisht në dy pellgje.			9	
6	Përshkruani rrjedhën e lumit Danub gjatë tërë territorit ballkanik. _____ _____ _____			10	
7	Analizo grafikun dhe sipas numrave shkruaj lumenjtë që kërkohen në hartë: 1 _____ 2 _____ 3 _____ 4 _____ 5 _____			11	

8		Regjioni Perëndimor	Prishtina Drenica Prizreni Lumi Drin Anamorava	11	
	<i>Rendit elementet përkatëse të regjioni përkatës.</i>				
9	“Bjeshkët e Nemuna”	2656m	Jugperëndim	Ereni	12
	asociacionit				
10	Vlerësoni rolin e resurseve natyrore për zhvillimin ekonomik të Kosovës. _____				13

<i>Perqindja</i>	0 - 39 %	40 % - 59 %	60% - 79%	80 % - 89 %	90% - 100%	Pikët : ()
<i>Pikët</i>	0 -39 pikë	40 - 59 pikë	60 - 79 pikë	80 - 89 pikë	90 – 100 pikë	()
<i>Nota</i>	1	2	3	4	5	()

Shenjat korigjuese: √- e saktë, x- e pasaktë, -- e paplotësuar Mësimdhënësi: _____

Tabela e testit për vlerësim numerik të pyetjeve sipas niveleve - Klasa IX

Fusha/Tema mësimore		Njohja	Të kuptuarit	Zbatimi	Mendimi kritik	Shuma
		20%	30%	10%	40%	100%
Gadishulli Ballkanik	20%	2 (16p)	1 (9p)	1 (10p)	Analizë - 1 (11p) Analizë - 1 (11p)	3 (57p)
Veçoritë natyrore dhe shoqërore të Kosovës	80%		2 (18 p)		Sintezë -1 (12p) Vlerësim - 1 (13p)	4 (43p)
Totali i pikëve	100%	16 pikë	27 pikë	10 pikë	47 pikë	100 pikë